

Platforma e Partisë Demokratike Shqiptare
për periudhën 2016-2020

Përmbajtja

Marrëveshja e re	5
I. Hyrje	5
II. Rishfaqja e nacionalizmit	6
III. Kontrata shoqërore dhe shtetet federative	7
IV. Marrëveshjet pa shqiptarë	8
V. Konflikti i vitit 2001 dhe MARRËVESHJA E OHRIT	11
VI. Marrëveshja e re	14
VII. Përmbyllja	16
Programi ekonomik i PDSH - së	18
Përmbajtja	18
Hyrje	19
Prioritete ekonomike në periudhën 2016-2020	20
a. Eliminimi i diskriminimit të planifikuar ekonomik të shqiptarëve dhe vendosja e mekanizmit institucional për barazi ekonomik-financiare mes maqedonasve dhe shqiptarëve;	20
b. Politika ekonomike në funksion të rritjes së qëndrueshme ekonomike;	20
1. Amnisti fiskale;	20
2. Rritje të qëndrueshme ekonomike;	20
3. Politikë monetare dhe devizore;	20
4. Politikë fiskale dhe menaxhim buxhetor;	20
5. Politikë tatimore;	20
6. Rritje të investimeve vendore dhe të jashtme, duke e përmirësuar klimën e biznesit;	20
7. Zona të lira ekonomike;	20
c. Politika në funksion të zhvillimit të sektorit të biznesit;	20
d. Zhvillim të agrobiznesit dhe industrisë ushqimore;	20
e. Infrastrukturë - si parakusht i rritjes së konkurrencës dhe mbështetjes së komunitetit të biznesit;	20
f. Zhvillim të turizmit;	20

g. Ekologji.....	20
A. Eliminimi i diskriminimit ekonomik të planifikuar të shqiptarëve dhe vendosja e mekanizmit institucional për barazi ekonomiko-financiare mes maqedonasve dhe shqiptarëve.....	21
B. Politika ekonomike në funksion të rritjes së qëndrueshme ekonomike	22
1. Amnistia fiskale	22
2. Rritje të qëndrueshme ekonomike	26
3. Politika monetare dhe devizore.....	27
4. Politika fiskale dhe menaxhimi buxhetor.....	28
5. Politika tatimore	29
6. Rritja e investimeve vendore dhe të jashtme duke e përmirësuar klimën e biznesit.....	32
7. Zonat e lira ekonomike	35
C. Politikat në funksion të zhvillimit të sektorit të biznesit.....	35
1. Nxitja dhe mbështetja e sektorit të biznesit.....	35
D. Zhvillimi i agrobiznesit dhe industrisë ushqimore	37
E. Infrastruktura si parakusht i rritjes së konkurrencës dhe mbështetjes së komunitetit të biznesit.....	39
F. Zhvillimi i turizmit.....	46
G. Ekologjia	47
i. Mbështetja e planeve lokale aksionare për mjedis jetësor (PLAMJ)	48
ii. Programi për investime në mjedisin jetësor	50
Arsimi	52
A. Gjendja aktuale	52
B. Fakte.....	54
C. Vizioni i pdsh-së për politikat e arsimit.....	54
Kultura.....	57
A. Elaborat për kulturën shqiptare.....	57
B. Qëllimet dhe prioritetet e kulturës shqiptare sipas përcaktimit të partisë demokratike shqiptare.....	60
C. Programi kombëtar për kulturë sipas përcaktimit të pdsh-së.....	62

Shëndetësia.....	65
A. Mbrojtja shendetësore të drejte dhe efikase	65
B. Çfarë e karakterizon sistemin aktual të shëndetësisë	65
C. Veprimtaria shëndetësore	65
D. Mbrojtjashëndetësorembrojtja shëndetësore primare	67
E. Mbrojtja shëndetësore sekondare dhe terciare.....	67

MARRËVESHJA E RE

PDSH-ja, pas shumë analizash të procesit të implementimit të Marrëveshjes së Ohrit, pas shumë kritikash të modifikimeve substanciale, të papërgjegjshme të kësaj marrëveshjeje dhe pas shumë hezitimesh të përgjegjshme doli me vlerësimin se Marrëveshjes së Ohrit jo vetëm që i ka skaduar afati, por ajo tanimë e ka humbur kuptimin e vet deri në atë shkallë, sa që është bërë pengesë për zhvillimin e mëtejshëm të shoqërisë mbi standardet e reja. Shpjegimin për dështimin e këtij projekti duhet kërkuar në rrethanat kompleks socio-historike.

I. HYRJE

Tashmë është e qartë se formacionet shoqërore, të çfarëdo provincie ideologjike qofshin ato, ndërtohen dhe funksionojnë mbiparimin e kontratës që në thelb është një marrëveshje juridikisht e formalizuar. Me kontrata të kësaj natyre rregullohen marrëdhëniet e individit me shoqërinë, raportet ndërmjet institucioneve me shoqërinë, individit me institucionet, të gjitha realacionet komplekse, të brendshme dhe të jashtme të një shoqërie. Kontrata është parimi që një shoqëri e shndërron në shtet. Në varësi nga cilësia e kontratës, ngamënyra se si ajo rregullon marrëdhëniet ndërmjet grupeve të ndryshme të interesit, atij ekonomik, financiar, kulturor, etnik, religjioz etj. vlerësohet funksionaliteti i një shteti. Në shtetet demokratike legjitimiteti për përfaqësim të interesit të një grupi fitohet përmes zgjedhjeve, që në esencë janë kontrata që një parti politike ose një individ lidh me elektoratin. Nëse pikat kryesore të kontratës nuk respektohen, atëherë shfaqet kriza në shoqëri.

Kohët e fundit sociologët, politikologët kanë filluar ta përdorin nocionin "shtete të dështuara" për ato formacione shoqërore që, për shkak të ndryshme nuk funksionojnë si duhet. Njëra nga shkaqet kryesore që e bëjnë një shtet jofunksional është injorimi, mohimi represiv dhe i vazhdueshëm i interesit të një segmenti në shoqëri që ka kapacitete të mjaftueshme ta kontestojë konceptin e shtetit, kontratën që, për interesa vetjake,

qëllimishtsegregon, një grup tjetër shoqëror që ka interesa të veçanta në atë shoqëri.

Nëse ky segregim vazhdon dhe imponohet me dhunë, atëherëkriza është e paevitueshme dhe këto shtete pandalshëm shndërohen nëformacione të dështuara shoqërore.Njëri nga faktorët kyç që ka kapicitet (de)stabilizues në të gjithashoqëritë është ai etnik. Shpërfillja e interesit të këtij faktori ndikon qëelementet e këtij grupi shoqëror të tregojnë jolojalitet ndaj sistemit qëshkakton distancën e rrezikshme etnike, ksenofobinë që përfundon medyshime paranojake. Në këtë klimë, beteja ndëretnike mugullon nëzona ilegale, në institucione jo formale ku hartohen projekte sekrete dhe merren vendime jo legjitime. Bie fjala, gjatë konfliktit të viti 2001në Maqedoni u suspendua institucioni i Këshillit të SigurisëNacionale ku merrnin pjesë edhe pjesëtarë të bashkësive të tjeraetnike dhe u formua një institucion jo legal, jo kushtetues, iashtuquajtur “kreu i shtetit” ku merrnin pjesë vetëm pjesëtarë tëkomunitetit maqedonas. Ky anashkalim i kushtetutës ndodh nëshoqëritë ku komuniteti tjetër etnik perceptohet vazhdimisht si armikqë duhet mbikqyrur, ose si kolonë e pestë, armik i brendshëm që duhetmbajtur në kontrollë.

II.RISHFAQJA E NACIONALIZMIT

Nacionalizmi ishte faktori që hyri në garë historike meideologjinë komuniste. Në fund, për shkak të thjeshtësisë së ofertës(nacionalizmi ofron atë që je, atë që e ke, ndërkaq komunizmi, siideologji totalitariste ofronte risi, njeriun e ri, atë që ende nuk je, apoende s’e ke), garën historike e fitoi nacionalizmi. Pjesa dërmuese ekomunistëve radikalë u bënë nacionalistë ekstremë).

Proceset shoqërore, ekonomike, politike që u zhvilluan kohët efundit dëshmuuan përfundimisht se nacionalizmi luajti një rol tërëndësishëm historik, të paktën në dy drejtime:

- në humbjen e kredibilitetit të ideologjisë komuniste dhe
- në shpërbërjen e formacioneve federative shoqërore dhekrijimin e shteteve kombëtare.

Nacionalizmi i popujve të Evropës Lindore u shfaq në skenëhistorike me një energji dhe vitalitet të pandalshëm, kështu që fare lehtë, si ideologji e re, e afërt me mendësinë e shtresave të gjerashoqërore, e zëvendësoi atë komuniste që ishte ashtëruar dhe molisur. Pakënaqësia e akumuluar në periudhën burokratike, represive komuniste, ndikoi që elitat e ndryshme, me ambicie të shfrenuara, me frymëzim dhe bindje të paluhatshme të fillojnë t'i formësojnë kauzat etyre kombëtare. Meqë ky artikulum nisi në të njëjtën kohë, antagonizmi ndërmjet elaborateve nacionale (serbe, kroate, sllovene, boshnjake, maqedonase etj.) ishte i paevitueshëm. Nga ana tjetër, mitizimi i interesit kombëtar krijoi një situatë ku nuk mund të zhvillohej një debat racional. Ashtu si ndodh zakonisht, nëse një problem nuk zgjidhet racionalisht, atëherë vijnë pasojat iracionale, lufta, pastrimi etnik, vrasjet, dhunimet, shkatërrimet, tragjedia që lehtëmund të evitohet.

III. KONTRATA SHOQËRORE DHE SHTETET FEDERATIVE

Zëvendësimi i ideologjisë komuniste me atë nacionaliste ndodhi në të gjitha shtetet e Evropës Lindore, por lufta shpërtheu vetëm në Jugosllavi dhe pjesërisht në BRSS (Rusi), pra në shtetet federative dhe jo në ato kombëtare. Shkakun duhet kërkuar te fakti se shtetet federative ndërtohen mbi kontrata komplekse, fragjile dhe të kushtueshme, ku parashikohen dhe garantohen të drejtat dhe obligimet e ndërsjella. Këto kontrata që lidhen ndërmjet popujve të ndryshëm nuk mund të jenë ideale dhe në vete përmbajnë interesa të politikës reale (gjerm. *real politik*), të politikës që e përfill kryesisht interesin e më të fortit. Nga ana tjetër vetë koha ndikon që segmente të caktuara të kontratës shoqërore të jenë bërë anakronike dhe se duhet të ndërrohen me zgjidhje më bashkëkohore. Nëse një formacion shoqëror federativ nuk 'federon', nuk i amortizon sfidat e kohës së re, nëse nuk pranon vlera të reja, atëherë kontrata e lidhur ndërmjet popujve, në vend që të ngjesh kohezionin e brendshëm shoqëror, nxitfërkime mbi baza etnike, që është faza më e hershme e një konfliktindër-etnik. Ky është procesi determinues që nuk mund të evitohet me retorikë të çfarëdo niveli. Sot Evropa po bashkohet, ndërkaq në shtetin ku janë instaluar institucionet e UE-

së, zhvillohen proceset diversifikues embi baza etnike (flaman dhe valone). Mirëpo, niveli qytetëruës, vetëdija demokratike e qytetarëve të këtij shteti ndikon që këto diversitete, antagonizma të zgjidhen me korrigjime të vazhdueshme të kontratës ndëretnike, ose, siç shprehen disa analistë, me “federim” të federatës.

Shpërbërja e Jugosllavisë nga goditjet e nacionalizmave të popujve konstituivë, vetvetiu hapi një problem që nuk u arrit të zgjidhet në mënyrë racionale. Shpallja e referendumeve në çdo republikë ishte në funksion të anulimit të kontratës federative dhenjëherësh të imponimit të kontratave të reja, por, pa pëlqimin e bashkësive të ndryshme etnike që me pavarësimin e republikave ushkëputën, pa vullnetin e tyre nga konteksti i më parë.

Në Maqedoni ky proces u zhvillua lehtë-lehtë për shkak të pozitës së pavolitshme të shqiptarëve, si në Shqipëri, Kosovë ashtu edhe në Maqedoni, por kjo s’do të thotë se këto tema nuk do të hapen në të ardhmen, veçmas nëse merret parasysh fakti se kushtetuta e re e shtetit të ri u ndërtua mbi konceptet e vitit 1989, kur arbitrarisht u degraduapozita e shqiptarëve në shoqëri. Por, siç dihet nacionalizmi-nacionalizmin e zgjon.

IV. MARRËVESHJET PA SHQIPTARË

Popujt sllavë të jugut, ashtu si popujt e tjerë të Ballkanit ishin njëkohë të gjatë nën sundimin e huaj, të Perandorisë Otomane ose Austro-Hungareze. Para dhe gjatë Luftës së Parë Botërore sllavët e jugut zhvilluan takime, konsultime dhe përfundimisht u morën veshqë ta themelojnë Jugosllavinë. Kjo kontratë fillimisht u arrit vetëm në mes të serbeve, kroatëve dhe sllovenëve. Shteti i ri që nga fillimi pati probleme me lojalitetin e popujve të papërfshirë në kontratë si dheme ambiciet për hegjemoni të serbëve, popullit dominant në shoqëri. Për ta ndrydhur këtë antagonizëm, të paevitueshëm përformacionet multi-etnike shoqërore, qeveria e mbretërisë së SKS nxori Proklamaten me të cilën i ngushtoi të drejtat demokratike dhe vendosi diktaturën mbretërore. Mosrespektimi i kontratës, mospërfshirja e popujve të tjerë në të, ndikoi që në vitin 1941 këtë shtet të sajuar të mos e mbrojnë askush, madje pushtuesi i ri, nazi-fashist, u prit me lule dhe entuziazëm nga qytetarët në të gjitha krahinat e shtetit të përbashkët.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, në v.1942 në Bihaq dhe në v.1943 në Jajcë, komunistët jugosllavë vendosën ta ringjallin Jugosllavinë qëparaprakisht e trajtonin si krijesë artificiale. Në kontratën e re u përfshinë të gjithë popujt sllavë të jugut, serbët, kroatët, sllovenët, boshnjakët, malazezët, maqedonasit, madje në një vend përmendet edhe Sanxhaku. Siç shihet në këtë kontratë nuk përmendet Kosovadhe as shqiptarët. Arsyeja është e thjeshtë. Mbi baza të së drejtës për vetëvendosje shqiptarët, në konferencën e Bujanit, e organizuar nga Komiteti Krahinor i PKJ-së, më 31 janar 1943, patën vendosur bashkë me delegatët serbë dhe malazezë të Kosovës që viset ku jetojnëshqiptarët t'i bashkohen Shqipërisë. Ky vendim, kjo kontratë më vonë në mënyrë të njëanshme do të anulohet në Mbledhjen e tretë të KAKÇKJ(AVNOJ)të mbajtur në Beograd, 7-10 gusht 1945.

Po ashtu në Maqedoni, në manastirin Prohor Pčinjski, më 2gusht(Ilinden) të v.1944 mbahet Mbledhja Antifashiste për Çlirim tëMaqedonisë (ASNOM, Antifasisticko Sobranie za Osloboduvanje na Makedonija) ku merren disa vendime, që ASNOM të jetë institucioni ivetëm vendimmarrës, që gjuha maqedonase të shpallet gjuhë zyrtare,që Ilindeni të shpallet ditë feste etj. Këto vendime i marrin 60 delegatënga 116 sa ishin zgjedhur për të marrë pjesë. Prej tyre asnjë nuk ishteshqiptar. Sipas modelit të AVNOJ-it edhe ASNOM-i mban trembledhje radhazi ku merren vendime edhe për shqiptarët pa prezencëne tyre. Vendimet e këtilla të njëanshme, pa marrëveshje, pa kontratë, në vend që të sjellin paqe dhe mirëqenie, u shndërruan në kode torturuese. Sipas të gjitha gjasave, mospërfilljet e shqiptarëve kanë qenë nëpërputhje me vendimet dhe marrëveshjet ndërshtetërore përshtëpërnguljen e shqiptarëve në Turqi.

Siç u theksua në hyrje, krizat në shoqëritë multietnike shfaqen kur njëpopull, me kapacitet demografik, ekonomik, politik,kulturor, demokratik nuk përfshihet në kontratën për ndërtim të shtetit, pormargjinalizohet vazhdimisht duke shpikur forma të ndryshme përpërtharje të perspektivave të tij.

Shqiptarët e Maqedonisë, që në vazhdimësi jetojnë si popullate shumicë në viset perëndimore të Maqedonisë që në mënyrë tënatyrshme ndërlidhen me viset e tjera shqiptare të Kosovës dhe të Shqipërisë, në mënyrë të pakuptimtë janë anashkaluar në momentet evendimmarrjeve historike. Ky injorim, pothuajse kudo në botë shërbensi pretext që populli i margjinalizuar ta

shfrytëzojë këtë shpërfilljepër mosbindje qytetare ose për jolojalitet ndaj shtetit.

Gjatë Jugosllavisë së dytë, udhëheqësia maqedonase, e mbështetur nga qendra e pushtetit – Beogradi, ushtronte një politikë represive që i tejkalonte masat që merrte regjimi i Millosheviqit në Kosovë. Me këtë rast do të përmendim vetëm disa shembuj: ndalimi i emrave kombëtarë shqiptarë, ndalimi i përdorimit të toponimeve në variantin shqiptar, imponimi i paraleleve të përziera me qëllim që të shuhet arsimit në gjuhën shqipe, ndalimi i përdorimit të flamurit, reduktimi drastik i numrit të nxënësve në shkollat e mesme etj.

Por, përjashtimi i shqiptarëve nga kontratat, ose shkelja e standardit bashkëkohor që shteti të ndërtohet mbi parimin e marrëveshjes u manifestua edhe në raste vendimtare historike, si biefjala në v.1989 kur, duke shfrytëzuar ofensivën e nacionalizmit serb, usollën një varg amandamentesh që i suspenduan një varg të drejtash të shqiptarëve të garantuara me kushtetutën e vitit 1974. Ky guxim, kjo arrogancë, kjo gatishmëri që të shfrytëzohet çdo oportunitet politik për t'i ngulfatur të drejtat dhe interesat legjitime të bashkëqytetarëve të tyre shqiptarë, pranë të cilëve jetojnë me qindra vjet, është faktori që në mënyrë ciklike i rrënon marrëdhëniet ndëretnike, besimin e ndërsjellë dhe vetë shtetin.

Kjo arrogancë në raport me shqiptarët u shfaq në mënyrë edhe më të padurueshme me rastin e hartimit dhe miratimit të aktit më të lartë juridik të një shteti, Kushtetutën e R. Maqedonisë, kontratës bazike që duhej t'i rregullonte relacionet komplekse në shoqëri. Deputetët, subjektet politike shqiptare dhe populli shqiptar në përgjithësi nuk u pajtuan me këtë kontratë që do të duhej t'i rregullonte marrëdhëniet ndërmjet dy bashkësive më të mëdha etnike, kështu që 10 vjet radhazi Maqedonia u bë model tipik i një shoqërie konfliktuale që në vitin 2001 përfundoi me konflikt të hapur.

Shkaku i luftës ka mundur të jetë i çfarëdo natyre, por masivizimi i tij spontan dhe i rrufeshëm ishte indikator i marrëdhëniet ndëretnike paskan qenë të përkeqësuar te mase, mirëbesimi i ndërsjellë nuk paska ekzistuar dhe se distanca etnike paska qenë ekstreme.

Në vend që të analizohen shtruar shkaqet e kësaj dukurie që kishte kapacitet për t'i rrënuar bazat e shtetit, subjekti politik maqedonas,

institucionet e shtetit, sistemi informativ, shkaqet e këtijkonflikti më me ëndje i kërkonin në teoritë e ndryshme të komplotit.

Ata asnjëherë nuk e analizuan tërësinë e procesit historik, përjashtimtarogant të shqiptarëve gjatë hartimit të kontratës për bashkëjetesë. Projekti maqedonas, prej ASNOM-it e këndeje ishte injorimi total i kontributit të shqiptarëve në këtë segment të përkufizimit të konceptit të shtetit. Të drejtat që ofronin ish-in në funksion të përtharjes të kulturës shqiptare.

V .KONFLIKTI I VITIT 2001 DHE MARRËVESHJA E OHRIT

Konflikti i vitit 2001 ishte i rrezikshëm për të dyja palët, jo vetëm për shkak të rrethanave të pavolitshme gjeostrategjike, por edhe për shkak se iniciatorët e konfliktit nuk kishin plan politik, ndërkaq kreu i shtetit s'dinte si ta menaxhojë situatën. Kjo situatë ndikoi që këto kontradikta të shndërrohen në mosdurim dhe urrejtje ndëretnike.

Palët në konflikt, duke mos pasur kurrajë për korrigjim të vlerësimeve, të paragjyqimeve gjithnjë e më tepër e rëndonin dhe e thellonin krizën. Në atë kohë vetëm PDSH-ja pati guxim, vlerësim të saktë të situatës dhe ide se si duhet të dilet nga ky qark vicioz. Në dallim nga faktorëtpolitikë maqedonas që konfliktin e shpjegonin me teori të ndryshme të konspiracionit ose me argumente që i demonizonin shqiptarët, si dhenë dallim nga nxitësit e luftës që përdornin argumente folklorike, të pakuptimta për faktorin ndërkombëtar, PDSH-ja hapi kapitullin që kishte të bënte me kritikën e mënyrës së krijimit dhe të ndërtimit të shtetit. Duke u ndërlidhur në paralajmërimet më të hershme përmundësinë e konfliktit ndëretnik në Maqedoni, duke sugjeruar arritjen e një marrëveshjeje të domosdoshme historike ndërmjet dy bashkësisëm të mëdha etnike, PDSH-ja e shtroi nevojën që shteti të ndërtohet mbi baza të një kontrate shoqërore ku në mënyrë precize do të garantoheshin të drejtat dhe obligimet. Ky ishte rrafshi i vetëm kumund të zgjidhej ky konflikt, ngaqë variantet e mëparshme, ku faktorishqiptar ishte mënjeluar nga të gjitha marrëveshjet,

detyrimisht dështuan. Pra, PDSH-ja, duke i ikur ligjërimin njolllosës, argumentoi se Kushtetuta e R. së Maqedonisë, koncepti i shtetit është gjenerator i krizës dhe se pa korrigjimin e kësaj kontrate, të kushtetutës, nuk mund të zgjidhet kriza. Faktori ndërkombëtar e kuptoi drejt këtë qasje të PDSH-së ndaj krizës dhe fuqimisht e mbështeti kërkesën për negociata. Siç dihet, pas shumë hezitimesh të faktorit politikmaqedonas, negociatat filluan në vilën presidenciale në Ohër, nënndihëheqjen e negociatorëve(pala maqedonase parapëlqente t'i quajë“olesnuvaçi”-lehtësues). Që në seancën e parë, pala maqedonase mbajti qëndrim, sa anakronik poaq edhe dogmatik, duke trajtuar shtetin si pronë etnike. U pa qartë se ata, të verbëruar nga një nacionalizëm posesiv, nuk kuptonin fare nevojën për një marrëveshjetë arsyeshme për parimet mbi të cilat do të ndërtohet shteti ipërbashkët, pra për domosdoshmërinë e lidhjes së një kontrate përmessë cilës do të krijoheshin kushte për identifikim, lojalitet të të gjithëqytetarëve ndaj shtetit. Ishte e padurueshme klima politike, intelektuale, refraktare qëkrijonte pala maqedonase. Ata ishin tëpavetëdijshtëm se prej fillimit mbanin pozicione antishqiptare. Kjo ishte e mishëruar në konceptet e tyre politike. Për ta ishte krejt ekuptueshme që të mohojnë kërkesën e shqiptarëve për përdorim tëplotë të gjuhës shqipe, për përfaqësim adekuat në institucionet dhe përshtetëzim të barabartë të oportuniteteve të sistemit. Për ta, njëherësh ishte krejtësisht normale që pala shqiptare të tregojë përgjegjësi, konstruktivitet dhe korrektësi ndaj interesit maqedonas. Gjatë tërë procesit të bisedimeve u pa qartë dallimi në mendësinë të dyja palëve: asaj refraktare, mohuese të përfaqësuesëve maqedonas dhe asaj kooperuese, afirmative të përfaqësuesve shqiptarë. Pas shumë debatesh, presionesh nga brenda dhe jashtë, veçmas pas përkeqësimit të situatës në zonat e krizës, u nënshkrua Marrëveshja e Ohrit që në vete ngërthente një varg kontradiktash, inkonzistencash, segregimesh, që paralajmëronin se marrëveshja, kontrata e parë e arritur mes këtyre dy komuniteteve do të jetë e pazbatueshme. Mjerisht koha tregoi se dyshimet ishin të sakta. Kjo gjithëmonë ndodh kur njëra nga palët kontarktuuese nuk tregonvullnet për respektimin e saj. Te pala maqedonase, në të gjitha segmentet e shoqërisë sot e kësaj dite dominon bindja se konflikti i vitit 2001 ishte fryt i komplotit të jashtëm, se Kushtetuta s'ështëdashur të ndërrohej fare, se shqiptarët janë mercenarë për interesa të huaj, se në këtë konflikt janë të përzier faktorët islamikë(prandaj u vranë ata 7 pakistanezë) etj. Në këtë

humnerë të dyshimeve u tret edhevullneti i faktorit maqedonas, fillimisht për arritje të marrëveshjes dhe pastaj për zbatimin e saj.

Ky refuzim për rregullim të raporteve ndëretnike përmes një marrëveshjeje të qëndrueshme dhe funksionale u shfaq në disa faza:

- në fazën e parë refuzohej nevoja për negociata dhe kërkohejmiratimi i kërkesës për zgjidhje të krizës me mjete ushtarake, sie drejtë legjitime e një shteti për mbrojtje. Në vazhdë të këtijvlerësimi qeveria e Maqedonisë importonte sasi të mëdha armatimi dhe ëndërronte që të kopjojë variantin kroat për qerrim të hesapave me shqiptarët;
- në fazën e dytë, kur u pa se nuk mund të evitohen negociatat, upërpoqën që ato të kenë profil të ulët, të quhen bisedime, ndërmjetësuesit të mos quhen negociatorë, por lehtësues;
- në fazën e tretë, gjatë bisedimeve me kokëfortësi kërkonin që sa më shumë t'i ngushtojnë kërkesat e shqiptarëve;
- në fazën e katërt, në atë të përmbylljes së negociatave, impononinformulime dualiste për të drejtat në përgjithësi, pastaj teknikëne reduktimit të të drejtave kushtetuese përmes ligjeve, të ligjeveme rregullore, dhe përfundimisht me refuzimin që të mospërmenden masat ndëshkuese në rast se marrëveshja nuk zbatohet. Kjo fazë konceptuale e marrëveshjes, e kontratës që do të duhej njëherë e mirë t'i qetësonte antagonizmatndëretnikë, përfundoi me zgjidhje segreguese. Kjo më së mirishihet te e drejta për përdorim zyrtar të gjuhës shqipe që nëkrahësim me gjuhën maqedonase është segreguar pesëfish;
- në fazën e pestë përdorën metodën e opstrukcionit, të zvarritjes së implementimit përfundimtar të Marrëveshjes së Ohrit. Afatipërfundimtar ka qenë viti 2004;
- në fazën e gjashtë, atë të nxjerrjes së ligjeve u modifikuankonceptet. Bie fjala formulimi i qartë dhe i obligueshëmkushtetues se gjuha të cilën e flasin më se 20% të qytetarëvepoashtu është në përdorim zyrtar u modifikua në variantinhipotetik”mund” të përdoret.

- Në fazën e shtatë u aktivizua mekanizmi i opstrukcionitburokratik, kështu që kjo Marrëveshje u shndërrua në pseudo-marrëveshje, në një paravan pas të cilit fshihet pozita e mjerë eshqiptarëve dhe cinizmi maqedonas.

VI. MARRËVESHJA E RE

Maqedonasit, për shkak të përqindjes së lartë të shqiptarëve nëstrukturën demografike të shoqërisë si dhe për shkak të paragjykimevetë trashëguara nga e kaluara, vazhdimisht i perceptojnë dhe i trajtojnëshqiptarët si element i huaj. Ky këndshikim krijon një barrierëpsikologjike që i pengon ata të ballafaqohen me realitetin.Ngufatja, modifikimi i kërkesave të shqiptarëve me manipulime llojesh të ndryshme të grupacioneve parapolitike shqiptare që u legjitimuan në mënyrë të dyshimtë, është metodë pune që gjithmonëka dështuar dhe do të dështojë. Në sistemet demokratike këto naivitetezbulohen lehtë, prandaj është e kotë që me kokëfortësi të përsëritengabimet e njëjta. Tashmë është e sigurt se nuk ka gjasa që shqiptarëttë zhduken nga këto hapësira, ashtu si imagjinojnë disa politikanë,është e sigurt se shqiptarët nuk do të mund të asimilohen, është esigurt përfundimisht se ata nuk do të heqin dorë nga kërkesa që të jenëtë barabartë në shoqëri, nga kërkesa që sistemi t’u ofrojë oportunitete tënjëjta të gjithë qytetarëve.

Kërkesa për marrëveshje të re është pasojë e modifikimit të palejueshëm të Marrëveshjes së Ohrit,aq më tepër që afati i saj ka skaduar.Modifikimet janë bërë në segmentet kryesore të M. së Ohrit, nëpërdorimin zyrtar të gjuhës shqipe, në përfaqësimin adekuat të shqiptarëve në sistem, që fshihet në mënyrë tinëzare me të dhëna tëpaverifikueshme statistikore, në konceptin e decentralizimit, nëfunksionimin e mekanizmit të konsensusit(vetos etnike), pastaj nëmosrespektimin e ligjit për amnisti, obligim që, megjithatë buron nga Marrëveshja e Ohrit, ashtu si masat e tjera për krijim të kushteve për mirëbesimi të ndërsjellë, siç ishte ideja e risocializimit të ish pjesëtarëve të konfliktit të vitit 2001. Raportet shqiptaro- maqedonase kategorizohen në tre periudhahistorike. Në atë të parën, ata ishin në të njëjtën pozitë, të bashkuar kundër sunduesit të përbashkët, osmanëve(Republika e Krushevës),serbëve(Jugosllavia e parë), në atë dytën maqedonasit janë në

aleancëanti-shqiptare, kryesisht me serbët, në atë të tretën vazhdojnë strategjinë e periudhës së dytë, por të vetmuar, pa përkrahjendoktrinare, financiare dhe ushtarake të aleatëve të mëparshëm. Këtëpohim e vërteton fati i Marrëveshjes së Ohrit, e cila u shndërrua nëmosmarrëveshje etnike e radhës. Këto cikle shkaktohen nga ambicietjoreale të maqedonasve që vazhdimisht përpiqen t'i marginalizojnëshqiptarët dhe ta përmirësojnë standardin e tyre jetësor në kurriz të shqiptarëve. Tanimë këtij sistemi të ngritur mbi interesa të bashkësisëdominante etnike i ka ardhur fundi. Maqedonia moderne, evropianeduhet të pajtohet me realitetin e brendshëm dhe të ndërtojë një sistem të barazisë së plotë. Kërkesa për marrëveshje të re, krahas konstatimit se Marrëveshjae Ohrit dështoi në implementim, ndonëse luajti rolin kyç në shuarjen ekonfliktit, mbështetet edhe në faktin e ekzistimit të realiteteve,standardeve të reja për zgjidhje të kontestëve ndër-etnike në rajon, siçështë Pakoja e Ahtisarit, ku parashikohen garanci të plota për ruajtjen e trashëgimisë kulturore serbe dhe për barazinë e tyre të plotë në sistem.Zakonisht marrëveshjet pa mekanizma për implementim të tyrembeten fjalë, retorikë që përkeqëson edhe më shumë situatën brenda një shoqërie. Marrëveshja e re, kontrata e re që do t'i përkufizojë të drejtat dheobligimet e ndërsjella të shqiptarëve dhe maqedonasve duhet tëgarantojë:

1. Zbatimin e plotë dhe në afat të caktuar të pikavetë marrëveshjes (kontratës). Në këtë vijë duhet të nxirret një ligj i veçantëku parashikohen masa ndëshkuese për shkeljet dhe zvarritjet, për tëgjitha manipulimet që ndikojnë që një e drejtë të bëhet epashfrytëzueshme;
2. Barazinë e plotë të shqiptarëve në sistem, si në shfrytëziminë begative të sistemit ashtu edhe në vendimmarrje. Kjo fushë do tëkontrollohet me parimin e konsensusit të plotë. Këtu bën pjesë edhendarja proporcionale e buxhetit. Nëse kjo ndarje nuk do të ishte ebarabartë, të drejtat e ofruara, ashtu si u theksua më lart, do tëshndërrohen në oferta të porealizueshme ;
3. Përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe pa segregime fyese;
4. Përfaqësimin adekuat të kontrolluar;
5. Marrëveshjen që njëri nga tre postet kryesore të shtetit (presidenti, kryeministri ose kryetari i parlamentit) t'i takojëpërfaqësuesit shqiptar;

6. Ligjine ri për funksionim konsensual të qeverisë;
7. Decentralizimin e njëmendtë në vend të dekoncentrimit që krijon iluzionin se mjetet buxhetore janë decentralizuar;
8. Ndarjen e re territoriale që merr parasysh aspektin etnik,kulturor, ekonomik, infrastrukturor;
9. Themelimin e institucioneve në funksion të zhvillimit tëvlerave kulturore shqiptare;
10. Respektimin e përpiktë të konceptit sekular të shtet;
11. Deetnizimine simboleve të shtetit, të himnit, të stemës dhe të simboleve të tjera shtetërore;
12. Përcaktimin strategjik dhe pa ekuivoqe për integrim nëNATO dhe UE.

VII. PËRMBYLLJA

(Mesazhi i kryetarit të partisë)

Jam i vetëdijshëm se shumë faktorë këto kërkesa do t'i cilësojnë si të papritura, befusuese, por të gjitha këto “argumente” s’do të kenë peshënë krahasim me manipulimet që qeveritë e ndryshme maqedonase me dekada të tëra kurdisnin kundër shqiptarëve. Jam i vetëdijshëm se kundër kësaj iniciative, si zakonisht, kurshtrohen kërkesa të këtilla të qarta, do të jenë shumë faktorë, tëbrendshëm dhe të jashtëm, por, si drejtues i një partie që në programine vet është obliguar t’i artikulojë interesat kombëtare, krijimin eshtetit që ofron shërbime të barabarta të gjithë qytetarëve, si drejtuespolitik i një partie që pa dilema është përcaktuar për vleratdemokratike, për integrim në UE dhe NATO, kam obligimin dhevendosmërinë e paluhatshme që t’i kundërshtoj të gjitha mashtrimetfyese që sot i bëhen popullit shqiptar në Maqedoni si dhe vlerave demokratike. Jam i vetëdijshëm dhe i bindur se sot në Maqedoni zhvillohet njëpolitikë e papërgjegjshme që sfidon paqen në të gjitha planet, si në atëtë brendshëm, me shqiptarët ashtu edhe në atë të jashtëm me fqinjët,prandaj e shoh të udhës që të dërgoj një porosi të qartë,

politikisht dhe moralisht legjitime, se populli shqiptar nuk mund të jetë më peng i politikave populiste qoftë të palës maqedonase apo të asaj shqiptare që politikën e perceptojnë ekskluzivisht si pjesëmarrje në pushtet. Jam i bindur se ka ardhur koha që interesi jetik i popullit maqedonastë mbrohet nga ata vet, nga ambiciet jo reale të koniunkturës qeverisëse.

Jam plotësisht i vetëdijshëm se me kërkesën për ripërtëritje të kontratës do të evitohen, jo vetëm fërkimet ndëretnike që sa vijnë poshtohen, por edhe zgjidhjet radikale që zakonisht shfaqen pasdështimit të marrëveshjeve; Përfundimisht jam plotësisht i bindur se kjo kërkesë e PDSH-së e stabilizon Maqedoninë, rajonin, demokracinë dhe vlerat e shoqërisë së hapur.

Prill 2014

Kryetari i PDSH-së

Menduh THAÇI

PROGRAMI EKONOMIK I PDSH - SË PËRMBAJTJA

- Eliminimi i planifikuar i diskriminimit ekonomik të shqiptarëve dhe vendosja e mekanizmit institucional për ekuilibër ekonomik dhe financiar në mes shqiptarëve dhe maqedonasve;
- Favorizimi i politikave ekonomike - shtetërore në funksion të rritjes së qëndrueshme ekonomike;
 1. Rritja eqëndrueshme ekonomike;
 2. Politika monetare dhe devizore;
 3. Politika fiskale dhe menaxhimi buxhetor
 4. Politika tatimore të favorshme për agjentët ekonomikë: familjet dhe bizneset;
 5. Rritja e investimeve vendore dhe të jashtme, duke e përmirësuar klimën e biznesit;
 6. Zhvillimii Zonave të lira ekonomike
 7. Politika ekonomike në funksion të zhvillimit të ndërmarrësisë dhe promovimit të iniciativës së lirë;
 8. Zhvillimi i agro - biznesit dhe industrisë ushqimore;
 9. Zhvillimi i infrastrukturës - si parakusht i rritjes së konkurrencës dhe mbështetjes së komunitetit të biznesit
 10. Zhvillimi i turizmit dhe ekologjisë

HYRJE

Në koncept, Republika e Maqedonisë ka një krizë më të thelluar në mes dy komuniteteve: komunitetit maqedonas dhe atij shqiptar, si rezultat i pabarazisë në drejtim të financave publike dhe shfrytëzimit jo - proporcional të mjeteve buxhetore, ku të parët e monopolizojnë konceptin e shtetit, si shtet me një kulturë dhe histori monoetnike, duke marginalizuar rajonet apo vendbanimet me shumicë shqiptare nga të gjitha segmentet e jetës publike e institucionale, duke filluar nga: buxheti, investimet vendore dhe të huaja, punësimet dhe avancimet, shkollimi, duke mos lënë anësh edhe politikën sociale. Edhe pse shqiptarët kontribuojnë me pagesën e detyrimeve tatimore dhe në rritjen e rezervave devizore me mbi 30%, ata janë të diskriminuar me një planifikim të sajuar nga ana e Qeverisë, ku atyre nuk u kthehet as për së afërmi kontributi që ata e japin në buxhetin e Republikës së Maqedonisë dhe ekonomisë së këtij vendi.

Aktualisht shqiptarët kërkojnë mekanizma institucionale për zgjidhjen përfundimtare të diskriminimit ekonomik të planifikuar që u bëhet atyre nga ana e Qeverisë. PDSH-ja i respekton këto kërkesa të shqiptarëve dhe u jep një rol dhe rëndësi të veçantë në programin ekonomik të saj dhe ajo merr përgjegjësi se është e vetmja parti shqiptare që mund t'i zgjidhë problemet ekonomike në fjalë. Për zgjidhjen e problemeve ekonomike PDSH-ja do të bazohet në prioritetet ekonomike si vijon:

PRIORITETE EKONOMIKE NËPERIUDHËN 2016-2020

- A. Eliminimi i diskriminimit të planifikuar ekonomik të shqiptarëve dhe vendosja e mekanizmit institucional për barazi ekonomiko-financiare mes maqedonasve dhe shqiptarëve;
- B. Politika ekonomike në funksion të rritjes së qëndrueshme ekonomike;
 - 1. Amnisti fiskale;
 - 2. Rritje të qëndrueshme ekonomike;
 - 3. Politikë monetare dhe devizore;
 - 4. Politikë fiskale dhe menaxhim buxhetor;
 - 5. Politikë tatimore;
 - 6. Rritje të investimeve vendore dhe të jashtme, duke e përmirësuar klimën e biznesit;
 - 7. Zona të lira ekonomike;
- C. Politika në funksion të zhvillimit të sektorit të biznesit;
- D. Zhvillim të agrobiznesit dhe industrisë ushqimore;
- E. Infrastrukturë - si parakusht i rritjes së konkurrencës dhe mbështetjes së komunitetit të biznesit;
- F. Zhvillim të turizmit;
- G. Ekologji

A. Eliminimi i diskriminimit ekonomik të planifikuar të shqiptarëve dhe vendosja e mekanizmit institucional për barazi ekonomiko-financiare mes maqedonasve dhe shqiptarëve

Bazuar në matjen e të hyrave publike, sipas qasjes së harxhimeve në strukturën e konsumit nacional, shqiptarët kontribuojnë me mbi 30% në shumën e përgjithshme të të hyrave buxhetore si dhe rritjen e rezervave devizore me mbi 30% që grumbullohen nga remitancat e mërgatës shqiptare, që jetonë dhe punojnë në botën e jashtme. Edhe pse shqiptarët kanë një kontribut të konsiderueshëm në të hyrat e përgjithshme buxhetore dhe në rritjen e rezervave devizore, ku si rrjedhim ata kontribuojnë në ruajtjen e stabilitetit makro-ekonomik, si parakusht themelor të funksionimit normal të procesit ekonomik, ata në vazhdimësi janë diskriminuar si në aspekt ekonomik ashtu edhe në aspektin financiar nga komuniteti maqedonas.

Investimet kapitale përfshijnë sfera të ndryshme duke filluar nga infrastruktura, arsimiti, kultura, shëndetësia, bujqësia, blegtoria, pylltaria dhe bletaria. Kjo pjesë e buxhetit është tepër e rëndësishme, sepse pa keto investime nuk mund të kemi një zhvillim ekonomik, kulturor dhe arsimor të mirëfilltë, respektivisht, nuk mund të zhvillohemi si komb. Investimet kapitale në strukturën e buxhetit në pjesën maqedonase realizohen në masën mbi 96% të mjeteve financiare, kurse në pjesën shqiptare vetëm 4%.

PDSH-ja në mandatin katërvjeçar do të angazhohet në eliminimin e diskriminimit të planifikuar ekonomik ndaj shqiptarëve dhe vendosjen e mekanizmit institucional të barabarsisë në ndarjen e mjeteve buxhetore, qoftë të harxhimeve korrekte ashtu edhe të harxhimeve të kapitalit. Kjo strategji do të realizohet me aprovimin e ligjit të vendosjes së një mekanizmi institucional që gjatë përpilimit dhe aprovimit të buxhetit mbi 30% të mjeteve buxhetore të alokohen te komuniteti shqiptar, aq sa ato kontribuojnë në buxhetin në fjalë.

Ndarje proporcionale dhe e drejtë e buxhetit, mundëson investime kapitale në zonat shqiptare të Maqedonisë dhe përmirëson disekulibrin ekonomik, në zhvillim dhe progres ekonomik në rajoneve të banuara me shumicë të popullsisë shqiptare dhe rajoneve të banuara me shumicë të popullsisë

maqedonase. Politika ekonomike e ndarjes proporcionale dhe të drejtë të buxhetit është në funksion të përmirësimit të standardit të jetesës dhe mirëqenies ekonomike të qytetarëve shqiptarë, si dhe në funksion të shpërndarjes normale të mirëqenies dhe standardit jetësor në mes gjithëqytetarëve. Politikisht, ndarja proporcionale e buxhetit, si në fazën e ndërtimit të buxhetit vjetor, ashtu edhe në fazën e propozimit të buxhetit për miratim, të kontrollohet me veto nga zëvendës kryeministri shqiptar.

B. Politika ekonomike në funksion të rritjes së qëndrueshme ekonomike

1. Amnistia fiskale

Amnistia fiskale, paraqet bazën reale për përmirësim të likuiditetit ekonomik të familjeve shqiptare dhe bazën potenciale për zhvillim të sektorit privat në suaza të ekonomise formale. Kjo politikë njëkohësisht, në plan afatmesëm, ndikon edhe në përmirësim të disiplinës fiskale të qytetarëve dhe bizneseve, që në perspektivë mundëson zvogëlimin e informalitetit me mekanizma stimulues për palët ekonomike (qytetarët dhe bizneset), pjesmarrëse në informalitet të detyruar. Masat konkrete që do të merren në kuadër të politikës së amnistisë fiskale për qytetarët dhe bizneset, përmes mekanizmave stimulues, do të eliminojnë përgjithmone, dënimet që u aplikohen qytetarëve dhe bizneseve mbi bazë të pjesmarrjes në informalitet ekonomik. Mekanizmat stimulues që derivohen nga politika e amnistisë fiskale, politikisht janë komplementarë me mungesën e politikave shtetërore për shpërndarje të drejtë dhe proporcionale të buxhetit shtetëror, sipas kriterit gjeografik dhe etnik dhe me mungesën e përkujdesjes shtetërore, ndaj bizneseve shqiptare me subvencione dhe masa të tjera lehtësuese fiskale.

Amnistia fiskale bëhet në një shtet në raste të jashtëzakonshme nevojë për likuiditet. Qeveritë e të gjitha llojeve, në mënyre frekvente, kanë aplikuar politika qeveritare që amnistojnë evaziorët fiskale, politika të amnestisë fiskale apo taksës fiskale, si pjesë të programeve të tyre qeveritare. Amnestia fiskale, e shpjeguar në mënyrë tipike, lejon individët apo firmat, të paguajnë taksën e papaguar më herët, pa qenë subjekt penaltetesh, sanksionesh dhe interesash financiare, që kryesisht vijnë me dimensionin e evazionit fiskal dhe informalitetit ekonomik.

Viteve të fundit, për afërsisht 40 shtete të SHBA-ve, kanë aktivizuar politikë të amnistisë fiskale. Gjithashtu, edhe disa vende evropiane kanë përvoja pozitive në këtë drejtim (Belgjikë, Francë, Irlandë, Itali dhe Zvicër) apo edhe vende të tjera në tranzicion, në pjesë tjera të botës. Qëllimi kryesor i politikës së amnistisë fiskale është rritja e të ardhurave afatshkurtra dhe freskimi i likuiditetit financiar në tregjet e kontrolluara.

Para aplikimit të politikës së amnistisë fiskale, autoritetet qeveritare, gjithsesi, duhet që të vlerësojnë nivelin e përgjithshëm të shlyerjes së detyrimeve fiskale nga agjentët ekonomik (personat fizikë dhe juridikë), në aspektin cilësor dhe sasior. Në veçanti, autoritetet qeveritare, duhet të përkufizojnë në mënyrë precize faktorët dhe shkaqet që kanë ndikuar në paraqitjen e evazionit fiskal dhe në rritjen e shkallës së mungesës së diciplinës fiskale si dhe problemet e pasojat që ka shkaktuar kjo politikë joeficiente taksash, që për pasojë ka sjellë evazionin fiskal, në sistemin ekonomik të vendit. Nëse shkaqet dhe pasojat e evazionit fiskal, nuk mund të adresohen saktë, është e pëlqyeshme që amnistia fiskale të shkaktojë rigjenerim të evazionit fiskal. Në këtë rast, taksapaguesit do të kuptojnë që problemet e sistemit fiskal nuk janë zgjidhur dhe për pasojë do të kenë tendencë të rritjes së jodiciplinës fiskale.

Me fjalët e tjera, aplikimi i politikës së amnistisë fiskale, pa identifikuar shkaktarët kryesor të paraqitjes së evazionit fiskal, stimulon edhe më shumë rritje të jolikuiditetit ndërmjet palëve pjesëmarrëse në transaksion dhe paraqitje të ekonomisë së trampës, shkëmbimit mall me mall, në përputhje me kriterin e koincidence së dyfishtë të nevojave. Prandaj është lehtësisht e kuptueshme që politikbërësit, gjenerues të politikës së gabuar fiskale, nuk mund të jenë promovues të politikës së saktë fiskale, që stimulon konkurrencën në sektorin privat, lufton evazionin fiskal dhe parandalon informalitetin në sektorin privat. Thënë ndryshe, politikbërësit që krijojnë evazion fiskal nuk mund të jenë amnistues të evazionit fiskal.

Vendimi i politikës së amnistisë fiskale duhet të plotësojë kriteret e pranueshmërisë dhe të përfshirjes. Amnistia fiskale duhet të specifikojë taksapaguesit e pranueshëm për amnisti. Është praktikë standarde t'u lejojë të gjithë taksapaguesve evazorë fiskal, pranueshmëri në këtë politikë amnestie, për sa kohë që detyrimet fiskale të pashlyera të evazorëve fiskal

nuk janë të njohura nga organet fiskale. Këta taksapagues, zakonisht, përfshijnë personat fizikë dhe juridikë që janë dhe nuk janë të regjistruar në organet fiskale.

Amnistia fiskale, gjithashtu, duhet të specifikojë edhe llojet e taksave që përfshihen në këtë politikë, si: taksat në të ardhurat personale, taksat në fitimet e korporatave, tatimin në fitim të firmave, tatimin në vlerën shtesë (TVSH) dhe taksat në patundshmëri. Kufizimi i llojit të taksave që mbulon politika e amnestisë fiskale, gjithashtu, kufizon edhe numrin e taksapaguesve që mund të përfshihen në këtë politikë. Prandaj, është krejtësisht e arsyeshme që politika e amnestisë fiskale të jetë joselektive. Amnistia fiskale, gjithashtu, duhet të mbulojë edhe kthimet e kapitalit, parave dhe ekuivalentëve të parave të qytetarëve rezident, të vendit të origjinës, që janë transferuar ilegalisht në vendin destinacion nga vendi i origjinës. Në këtë mënyrë, paratë jolegale, të legalizuara përmes politikës së amnestisë fiskale, në mënyrë të kontrolluar brenda një kuadri rregullues ligjor, gjithashtu, mund të përdoren për qëllime të investimeve produktive që gjenerojnë punëzënie dhe mirëqenie sociale.

Politika ekonomike e amnestisë fiskale, e sugjeruar nga përvojat pozitive të shteteve që kanë aplikuar këtë politikë ekonomike, që teoritikisht pritet të ketë efekte pozitive në ekonominë e Maqedonisë, mund potencialisht të përfshijnë masat vijuese:

1. Pezullim të aktiviteteve të përmbauesve, deri në dhënien e efekteve të para pozitive nga politika e amnestisë fiskale.
2. Evazorët fiskalë të jenë të lirë të deklarojnë të gjitha mjetet monetare të palegalizuara, që për kundërvlerë të këtij deklarimi do të ishte pagesa e një vlere simbolike të shumës së mjeteve të palegalizuara monetare, thuaj 1 deri 2 %, organeve fiskale.
3. Individëve t'u falen të gjitha gjobat dhe intereset financiarëtë llogaritura në vonesa për taksat dhe tatimet e papaguara si dhe kamatvonesat mbi bazë taksash e tatimesh të papaguara, qofshin taksa e tatime lokale apo shtetërore.
4. Detyrimet e papaguara të firmave, që lidhen me importet e aktiveve materiale, t'u falen gjobat dhe interesat e llogaritura doganore, nëse paguhet një pjesë e konsiderueshme e principalit të detyrimit, në masën prej 50% të vlerës importuese të aktivitetit të importuar.

5. Bizneset që paguajnë 50% të principalit të borxhit doganor, të deklaruar në bilancet e tyre, në vitet e mëhershme, t'u falet borxhi i mbetur doganor. Ndërsa bizneset që paguajnë 100% të principalit të borxhit doganor, të deklaruar në bilancet e tyre në vitet e mëvonshme, t'u falen vetëm gjrobat, penalitetet dhe kamatë vonesat mbi vlerat kontabile të borxhit.
6. Biznesit të vogël, që nuk është i pajisur me arkë fiskale deri në një afat të caktuar, thuaj fundi i vitit 2015, t'i falen të gjitha gjrobat dhe kamatë vonesat për mosvendosje të këtyre pajisjeve, me kushtin e vendosjes së tyre brenda një periudhe të caktuar kohe.
7. Të gjithë firmat e regjistruara në regjistrin qendror, që operojnë në sektorin privat, që deklarojnë në bilancet e tyre aktive (pasuri të patundshme dhe mjete të tjera materiale dhe jomateriale, si tokë, makineri, objekte ekonomike, goodwill, patenta, licensa) me vlerë kontabile më të ulët se vlera e tregut, t'u mundësohet rivlerësimi i pasurive të tyre, duke i deklaruar vlerat e rivlerësuara të pasurive në bilancet e viteve pasardhëse.
8. Firmave t'u falet i gjithë borxhi tatimor e doganor i deklaruar si i papaguar deri para 3 viteve. Ndërsa pas 3 viteve, thuaj pas vitit 2013, firmave t'u falen vetëm gjrobat dhe kamatë-vonesat që lidhen me borxhet tatimore e doganore të papaguara. Kjo politikë do të stimulonte rigjenerimin e firmave të dala nga tregjet në të cilët kanë operuar deri në vitin 2013 dhe gjithashtu rritje të numrit të bizneseve të vogla.
9. Të gjithë sipërmarrësve individual (firmave të shitjes me pakicë dhe shumicë, firmave të shërbimit e ndërtimit etj), që nuk kanë raportuar ushtrim të veprimtarisë profitabile në organet fiskale, t'u falen të gjithë gjrobat dhe kamatë-vonesat në gjoba si dhe përndjekjet penale, duke u detyruar këto firma, në këmbim të regjistrohet në organet fiskale.
10. Të gjithë të punësuarëve, të padeklaruar si të punësuar në organet kompetente, t'u falen detyrimet ndaj kontributeve për sigurime shëndetësore, sigurime sociale si dhe gjrobat e kamatë- vonesavetë shoqëruara me këto gjoba, si rezultat i mosshlyerjes në kohë të këtyre detyrimeve, duke u detyruar këta të punësuar, në këmbim të deklarohen në organet kompetente.

11. Përgjithësisht, politika e amnitisë fiskale është domosdoshmëri e kohës që pritet të ketë efekte pozitive në disa dimensione, si: rritje të likuiditetit financiar në sektorin privat; rritje të numrit të bizneseve të vogla, që legalisht ushtrojnë veprimtari profitabile në përputhje me ligjet në fuqi; rritje të mundësisë së shlyerjes së detyrimeve tatimore e doganore të sektorit privat ndaj organeve fiskale lokale dhe shtetërore; rritje të të ardhurave publike në nivel të qeverisë lokale dhe shtetërore dhe projektim më të saktë të investimeve publike, të cilët do të gjenerojnë punëzënie dhe mirëqenie sociale.

2. Rritje të qëndrueshme ekonomike

PDSH-ja do të anagazhohet në mënyrë aktive në përpilimin e politikave ekonomike, që do të mundësojnë një rritje të shpejtë dhe të qëndrueshme ekonomike. Ne nuk do të fokusohemi vetëm në politika që japin rezultate afatshkurte, por, edhe në politika që do të japin rezultate afatgjate. Vështirë të realizohet rritje e qëndrueshme ekonomike nëse politikat ekonomike janë të orientuara vetëm në dhënien e rezultateve ekonomike afatshkurte e jo edhe në ato afatgjate. Kjo u bë e qarte gjatë krizës globale ekonomike. Shpresë e kotë në periudhat e kaluara nga promovimet për një ekonomi të fuqishme, e cila mbeti vetëm në letër, kurse në anën tjetër mbeti një ekonomi me deficit buxhetor dhe rritje të borxhit publik për gjeneratat e ardhshme, me rritje të lartë të normave të interesit (më të larta se mesatarja e profitit në biznes), dhe me shkurtrim të investimeve private nga kreditimi i sistemit bankar në favor të kreditimit të investimeve publike jo produktive, sic është Projekti - Shkupi 2014. Parametrat tjera që e vështirësojnë funksionimin normal të ekonomisë janë: Jolikuiditeti në sektorin privat, importimi i të mirave jo produktive, gjyqësia e varur dhe e politizuar, korrupsioni i lartë, kostoja e lartë për të filluar biznes, mungesa e lirisë ekonomike, etj. Kjo detyrimisht çon në ndryshime të koncipimit dhe realizimit të politikave ekonomike, që do të orientoheshin në funksion të rritjes së qëndrueshme ekonomike.

PDSH-ja ofron politika ekonomike që do të jenë të orientuara në konsistencë me një kornizë të shëndoshë makro-ekonomike edhe atë:

1. Rritja e prodhimit nacional në sektorët me përparësi krahasuese e jo alokim të burimeve ekonomike në sektorët ku nuk ka një përparsi të tillë dhe realizim të qëndrueshëm të rritjes ekonomike afatgjate prej

5-7%, në përputhje me kriteret për rritje ekonomike afatgjate, përpiluar nga institucionet financiare ndërkombetare si: FMN dhe Banka Botërore;

2. Rritja e investimeve të vendit dhe të huaja në sektorin e prodhimit dhe zgjerimi i kapaciteteve ekzistuese prodhuese, e cila do të mundësojë krijimin e vendeve të reja të punës;
3. Orientim të politikave në mbështetje të sektorit prodhues, i cili është orientuar në eksport dhe si rrejdhim do të ngushtojë hendekun në mes importit dhe eksportit si problem struktural afatgjatë;
4. Promovim të politikave ekonomike në drejtim të zvogëlimit të harxhimeve jo produktive dhe rritja e investimeve kapitale si komponente zhvillimore e buxhetit;
5. Ulja e normave të interesit të sistemit bankar në kreditimin e ekonomisë me abondimin gradual të bonave të thesarit që emitohen nga Banka Qendrore, kurse kjo do të mundësojë gjithashtu edhe zhvillimin e sektorit financiar;
6. Kthimi i besimit të investitorët e huaj përmes promovimit të gjyqësisë efikase dhe plotësisht të pavarur, zvogëlimit të korrupsionit, promovimit të lirisë ekonomike, etj.

3. Politika monetare dhe devizore

Politika monetare është në kompetencë të Bankës Qendrore, si institucion i pavarur, që ndikon në përcaktimin e strategjisë monetare dhe instrumenteve të saj për mirëmbajtjen e stabilitetit makro-ekonomik ose stabilitetit të çmimeve. Stabiliteti i kursit devizor do të mbështetet si determinante e stabilizimit të lëvizjes së çmimeve në ekonominë e vendit. Nëse Banka Qendrore vendos të targetojë inflacionin në vend të targetimit të kursit devizor, ne nuk do të bartim përgjegjësi nga destabilizimi eventual të stabilitetit makroekonomik. Gjithashtu, kordinimi i mirëfilltë i politikës monetare dhe fiskale është mjaft i rëndësishëm për krijimin dhe mbajtjen e stabilitetit makro-ekonomik, si parakusht bazik në projeksionet e aktiviteteve dhe investimeve afatgjate në komunitetin e biznesit. Presim një koordinim më të fuqishëm të politikës monetare dhe fiskale, i cili si i tillë nuk ka qenë i mjaftueshëm në vitet e fundit dhe si rrjedhim kjo do të ndikojë në rritjen e kredive bankare prej 30-40%. Kjo është e domosdoshme në mbështetjen e komunitetit të biznesit dhe konsumatorëve. Gjithashtu, presim nga Banka

Qendrore gradulisht të abondojë bonat e thesarit si instrumente tranzitore dhe sterilizimin e tepicës së likuiditetit në sistem bankar, e cila do të çon në uljen e normave të interesit dhe në zhvillim dhe zgjerim të tregjeve financiare. Me këtë, Banka Qendrore gradulisht duhet të përgatitet për sfidat e ardhshme në intensifikimin e integritimeve financiare në aspekt global dhe rajonal.

Definitivisht, Banka Qendrore duhet të përdorë strategji monetare në optimizimin e efekteve ekonomike me një inflacion të ulët, përgatitje për inkuadrimin e Euros si valutë nacionale dhe minimizimin e fluktacionit të sektorin të biznesit.

4. Politika fiskale dhe menaxhimi buxhetor

Politika fiskale në periudhën e kaluar ka qenë ekspansioniste në rritje të harxhimeve jo produktive (projekti Shkupi 2014), e cila shpesh ka rezultuar me restriksion të politikës monetare, respektivisht, me rritje të normave të interesit dhe si rrjedhim në shkurtrimin e investimeve private. Kjo tregon se nuk ka patur koordinim të mirëfilltë të politikës fiskale dhe monetare, respektivisht, mes Ministrisë së Financave dhe Bankës Qendrore. Rritja e harxhimeve jo produktive i referohet ndërtimit të muzeve, përmendoreve dhe marketingut për promovim të qeverisë.

Shikuar politikën fiskale nga ky këndvështrim, PDSH-ja do të angazhohet në koncipimin e politikës fiskale e cila do të ketë karakter zhvillimor duke i shkurrtuar harxhimet jo produktive në favor të rritjes së investimeve të kapitalit. Ne do t'i ndjekim dhe aplikojmë eksperiencat e vendeve të zhvilluara sipas së cilave investimet kapitale në sferën e energjistikës, infrastrukturës, arsimit dhe shëndëtsisë dhe do të mbështesin zhvillimin ekonomik në afat të gjatë. Investimet e kapitalit që do të mbështesin rritjen ekonomike duhet të sillen në nivel prej 7% në raport me GDP-në.

Rritje e deficitit fiskal dhe huasë publike duhet të udhëhiqet me përgjegjësi dhe disiplinë fiskale, sepse aq sa financohen investimet publike, për aq zvoglohen investimet private. Që të eliminohet efekti i reduktimit të investimeve private si rezultat i masave restriktive në politikën fiskale, politika ekonomike e PDSH - së do të mbështetet në moton: Më pak para për qeverinë dhe më tepër para për komunitetin e biznesit. Kjo nënkupton më tepër investime private dhe më tepër vende punë e gjithë kjo çon në rritjen e

mirëqenies nacionale. Gjithashtu, kur qeveria rrit borxhin publik me kosto të lartë, veçanarisht për harxhime jo produktive, ajo ngarkon gjeneratat e ardhshme për pagesën e saj. Andaj, PDSH-ja do të angazhohet për një politikë fiskale të udhëhequr me përgjegjësi dhe dicitlinë fiskale, ku deficitit fiskal dhe huaja publike do të jenë në kuadër të kriterëve të Marrëveshjes së Mastrihtit dhe rekomandimeve të raportit të Pribes që kanë të bëjnë me zvogëlim të shpenzimeve joproduktive.

Përfundimisht, PDSH-ja do të orientohet në urgjencën e konsolidimit fiskal në përmirsimin e strukturës së harxhimeve publike në favor të investimeve të kapitalit, deficitit fiskal më pak se 3%. Një politikë e tillë fiskale do të kontribuojë në zhvillimin ekonomik afatmesëm dhe afatgjatë si dhe konvergencën e vendit drejt përmbushjes së kriterëve të Marrëveshjes së Mastrihtit si parakusht për qasje në Unionin Monetar Europian.

5. Politika tatimore

Sa i përket politikës tatimore, PDSH-ja do të angazhohet në barabarësinë e shtresave të shoqërisë. Ne do të ofrojmë model në aplikimin e normave tatimore progresive në tatimin e të ardhurave, që do të thotë të pasurit të paguajnë më tepër tatim, kurse të varfurit të paguajnë më pak tatim. Ky lloj tatimi do të mundësojë zvogëlimin e diferencave në mes klasave në shoqëri. Abondimi i tatimit të sheshtë (flat rate tax) është i domosdoshëm sepse i njëjti është përdorur në vitin 1913 dhe kohën e fundit është përdorur në vendet Baltike, mirëpo, këto vende e kanë abonduar tatimin në fjalë. Qëllimi i këtij lloji të tatimit ka qenë rritja e efikasitetit ekonomik dhe zvogëlimi të papunësisë, mirëpo, kjo ngeli vetëm në letër sepse i njëjti nuk dha rezultate të lakmushme për qëllimin në fjalë. Si argument tjetër është se pjesa më e madhe e vendeve të zhvilluara perëndimore nuk e përdorin tatimin e sheshtë, por, ata përdorin tatim mbi të ardhurat me norma progresive.

Aplikimi i taksës progresive në të ardhura, në vend të taksës së sheshtë (flat rate tax), mundëson zvogëlimin e diferencave në mes klasave në shoqëri. Aplikimi i taksës progresive ofron drejtësi ekonomike, më shumë liri për zhvillim dhe kontribut më të drejtë në buxhet, të të gjithë përfituesve në tregje të vecanta. Taksa e sheshtë, përkundër përshtypjes pozitive që le në zgjerim të bazës tatimore (përfshirjes më të gjërë të tatimpaguesve), ajo rëndon më shumë padrejtësisht këdo që ka të ardhura më të ulëta, potencialisht të punësuarit në sektorin publik dhe bizneset e vogla dhe të

mesme dhe nga ana tjetër mundëson përfitime të pamerituara për bizneset e mëdhaja, monopole (si p.sh: EVN) apo oligopole (si.p.sh: T-Mobile, ONE, VIP dhe të tjera) duke pakësuar, komponentën e kërkesës agregate, për pjesën e të ardhurave të buxhetit në raport me PPB-në, dhe mundësinë e rikthimit të të ardhurave publike në shpenzime publike, në funksion të rritjes së mirëqenies sociale, standardit të qytetarëve dhe gjenerimit të punëzënies. Politika e taksës progresive në anën tjetër është në pajtueshmëri me principet ekonomike të Kopenhagës, principe ekonomike këto të njohura për vendet kandidatë për integrim në Bashkimin Evropian, që në anën tjetër garanton zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, dukë mbajtur llogari për shpërndarje normale të mirëqenies. Aq më shumë, në kushtet të tilla ekonomike për Maqedoninë, ku të ardhurat për frymë (PPB ose GDP për frymë), paga mesatare dhe paga minimale, janë dukshëm më të ulëta, se mesatarja e shteteve të Ballkanit Perendimor, politika e taksës progresive mbron më së miri individët me të ardhura të ulëta dhe bizneset e vogla me fitime të ulëta. Në anën tjetër, duke konsideruar faktin që pronarë të aseteve të privatizuara të ekonomisë publike në Maqedoni, janë kryesisht persona fizik dhe juridik të popullsisë Maqedonase, pasi që botërisht është e njohur që politika e privatizimit ka qenë e njëanëshme, ku shqitparët kanë qenë të privar nga benefitet e privatizimit, politika e taksës progresive politikisht është kundërvlera më e saktë e politikës së gabuar të privatizimit. Me fjalë tjera, përmes politikës së taksës progresive, kompanive monopolistike dhe oligarke maqedonase, të cilët janë përfituar si rezultat i privatizimit, u ngarkohet përgjegjësi më e lartë financiare për shpërndarje normale të mirëqenies.

Përveç kujdesit që ne do të kemi ndaj drejtësisë, PDSH-ja politikën tatimore do ta dimenzionojë në drejtim të nxitjes së investimeve dhe biznesit, d.m.th. të nxitjes së efijencës ekonomike. Këtë do ta realizojmë nëpërmjet zvogëlimit të normave tatimore, e cila çon në kosto më të ulët për biznesin, respektivisht më tepër para për biznesin, rritje të investimeve që ndikon në uljen e papunsisë dhe rritjen e mirëqenies shoqërore. Shtyllat kryesore në stimulimin e efijencës së tregut e cila do të çojë në rritjen e investimeve dhe rritjen e punsimit do të realizohet si vijon:

1. Të rritet norma e përqindjes së TVSH-së që ndahet për vetadministrimin lokal nga 3% deri në 10%, në menyre që të gjenerohet kapaciteti real fiskal i qeverive lokale, avansimi i

- komunave shqiptare në konsum dhe rritja e cilësisë së sherbimeve publike që sigurohen nga qeverisja lokale.
2. Ulja e kontributeve sociale për 8%, gjë që çon në ulje të kostos së biznesit dhe punsime të reja;
 3. Lirimi nga tatimi në fitim i kompanive që do të reinvestojnë profitin e tyre;
 4. Lirim nga tatimi në fitim shumë të kontributeve që do të paguajnë punëdhënësit që do të punojnë puntorë të rinj me kohë të pacaktuar. Ky lloj lehtësimi tatimor do të zgjasë 2 vite.
 5. Lirim nga tatimi në fitim i themelimit të biznesit në pjesët rurale dhe jo të zhvilluara në periudhë prej 5 vitesh;
 6. Zero tatim për repromatrialet dhe paisjet për sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë;
 7. Zero doganë për repomatrialet, të mirat dhe paisjet që nuk prodhohen në vend;
 8. Do të zvogëlojmë tatimin në lartësinë e kompenzimit tek kompanitë që do të paguajnë për studentët që do të punojnë tek kompanitë në fjalë;
 9. Rritja e akcizës tek mallrat luksoze.
 10. Politike tatimore që favorizon konsumin privat dhe publik të qytetareve
 - a. Ulje të normës së TVSH-së, në mallrat e konsumit privat, nga 18% në 15%.
 - b. Ulje të normës së TVSH-së, në konsumin e të mirave publike (Energji elektrike, faturat ndaj ndërmarjeve publike), nga 18% në 10%, si dhe heqje të 33.33%-shit, që aplikohet mbi faturat e EVN-së.
 - c. Kthim të TVSH-se, personave fizik, në fund të vitit fiskal për mallrat e konsumit privat, me qëllim të rritjes së buxhetit vjetor të familjeve, avansimit të pjesmarjes së konsumit në PPB, (që paraqet targetin kryesor ekonomik, që aplikohet në vendet me ekonomi në zhvillim) dhe përmiresimin e likuiditetit të agjentëve ekonomike, familjeve dhe bizneseve. Kjo politike ekonomike pritet të jep rezultate pozitive në periudhë afatshkurter, nga 4 në 8 vite. Kthimi i TVSH-se, për

mallrat e konsumit privat, qytetarëve, paraqet politikën kryesore ekonomike kundër informalitetit në sektorin privat, me c'rast informaliteti në këtë sektor luftohet me mekanizma stimulues për qytetarët. Politika e kthimit të TVSH-së, duhet të fillojë pas efekteve të para pozitive nga politika e amnistisë fiskale, në mënyrë që të ruhet ekuilibri buxhetor në aspekt kohor, nga aplikimi i politikës së amnistisë fiskale dhe politikës së kthimit të TVSH-së. Evidenca empirike sugjeron lidhje pozitive në kuptimin shkak-pasojë, në mes këtyre dy politikave. Pra, amnistia fiskale, në periudhe afatmesme ndikon në përmirësim të disiplinës fiskale të agjentëve ekonomik (qytetarëve dhe bizneseve), dhe disiplina fiskale e rritur nga efekti i amnistisë fiskale ndikon në rritje të nivelit të formalizimit të ekonomisë, vecanërisht në sektorin privat, kryesisht përmes politikës së kthimit të TVSH-së, qytetarëve, për mallrat e konsumit privat.

6. Rritja e investimeve vendore dhe të jashtme duke e përmirësuar klimën e biznesit

Qeveria aktuale dështoi në tentimin për ta promovuar vendin si atraktiv për investuesit e huaj. Të dhënat zyrtare gjatë viteve të fundit flasin se investimet e huaja ngelin më të ulta krahasuar me vendet e rajonit.

Qeveria aktuale, arsyet për nivelin e ulët të investimeve të huaja, sidomos gjatë viteve të fundit, i fokuson në krizën globale ekonomike, kurse daljen nga kjo situatë e mbështet në mëkëmbjen e vendeve të zhvilluara të Bashkimit Evropian. Përpos arsyeve të këtyra, nuk mund ta lëmë anësh politikën stagnuese qeveritare për sa i përket proceseve të integritimit, që në mënyrë të drejtpërdrejt e bën të pasigurt kapitalin e huaj. Mos lëmë anësh edhe raportet e përkeqësuar në planin e brendshëm politik, sidomos marrëdhëniet ndëretnike në mes të komunitetit maqedonas dhe atij shqiptar. Gjithashtu, politizimi i gjyqësorit do të thotë se mungon qëndrueshmëria ligjore për mbrojtjen e kapitalit të huaj. Ndryshimi i vazhdueshëm i ligjeve, çështjet e papastuara pronësore-juridike, administrata joefikase dhe

mosinvestimi në infrastrukturë, poashtu janë disa nga shkaqet se pse në Maqedoni investimet e huaja janë modeste për dallim nga rajonit.

Duke u ndërlidhur me atë që theksuam paraprakisht, mund të konkludojmë se Maqedonia në fushën e administrimit dhe menaxhimit të investimeve, qofshin ato investime të huaja apo të brendshme, si në nivel lokal poashtu edhe në atë qendror, ende po merret me ngarkesën e trashëguar para pavarësisë dhe tiparet që e kanë shoqëruar këtë ngarkesë, si burokracia e madhe dhe mungesa e transparencës.

Strategjitë dhe politikat investuese të qeverisë kanë qenë diskriminuese në baza etnike. Zonat ku janë përqendruar Investimet e Huaja Direkte (IHD) janë zona të banuara me popullatë maqedonase dhe infrastrukturë më të zhvilluar. Edhe sot e kësaj dite këto politika marginalizojnë pjesën veriperëndimore të vendit, përkundër kushteve të favorshme për zhvillimin e turizmit, pozitës gjeografike si prioritet i donatorëve në rajon, transportit dhe lidhjeve ndërkufitare. Ç'është më e keqja, qeveria vazhdimisht e promovon këtë rajon si rajon të rezikshëm për investime.

Partia Demokratike Shqiptare, me qëllim të vëndosjes së ekuilibrit ekonomik në zhvillim në mes zonave shqiptare me ato maqedonase, planifikon që brenda mandatit qeverisës, 2016-2020, të realizojë projektet vijuese

1. Integrim në strukturat veriatlantike, njëherit edhe siguri të plotë ekonomike;
2. Përmirësimin e imazhit të Maqedonisë Veriperëndimore tek investitorët e huaj;
3. Zgjidhjen e çështjeve pronësore-juridike mbi tokën dhe lehtësimin e procedurave burokratike për aprovimin dhe dhënien e lejeve të ndërtimit, që është bariera kryesore ndaj investimeve të huaja;
4. Zvogëlimi i informalitetit në ekonomi, për të siguruar një konkurrencë të ndershme në treg;
5. Funkionimin e gjyqësisë së pavarur dhe sigurimin e qëndrueshmërisë ligjore për mbrojtjen e kapitalit;
6. Funkionimin e plotë të institucioneve publike dhe luftimin e korrupsionit;

7. Përmirësimin e imazhit të vendit ndaj investitorëve të huaj, duke përmirësuar thelbësisht situatën politike, që është një garanci e fortë për investitorët e huaj dhe të vendit;
8. Zvogëlimin e harxhimeve për infrastrukturë si transport, energji, ujë, etj, me qëllim të rritjes së efikasitetit të bizneseve;
9. Përmirësimin e shërbimeve financiare, bankare dhe jobankare: nivel më të lartë të kreditimit, rritjen e cilësisë së shërbimeve financiare për tregti ndërkombëtare, uljen e shkallës së interesit, rritjen e nivelit të shërbimeve nga kompanitë e sigurimit, etj;
10. Informim më të mirë të diasporës dhe ndihmë për të investuar në vend;
11. Rritjen e investimeve në turizëm, duke shfrytëzuar pasuritë e shumta natyrore;
12. Rritjen e mundësive për eksport, në veçanti duke mënjanuar barrierat në kufi;
13. Krijimin e kushteve që kompanitë e huaja të mund t'u besojnë kompanive vendase një pjesë të aktivitetit të tyre (outsourcing), si:
14. shërbime të teknologjisë së informacionit (IT),
15. qendra për kujdes ndaj klientit (Customer Support Centers),
16. qendra për përpunimin e të dhënave (Data Processing),
17. seli rajonale për bizneset (Regional Headquarters);
18. Promovimin e mundësive për prodhimin e ushqimeve organike, për të cilët ka një kërkesë në rritje në tregjet europiane;
19. Jetësimin e zonave të lira ekonomike;
20. Nxitjen dhe zhvillimin e projekteve të investimit në partneritet me sektorin privat dhe aplikimin e skemave koncesionare;
21. Krijimin e biznes-klubeve me ekspertë për planifikime strategjike, investime dhe financime, ndërmarje të përbashkëta, partnership, blerje dhe transfera teknologjike etj.
22. Fuqizimin e Agjencionit për Thithjen e Investimeve me burime njerëzore të reja (rekretim dhe formim të stafit) dhe krijimin e agjencioneve private për thithjen e investimeve të huaja në Maqedoninë veriperëndimore.

7. Zonat e lira ekonomike

Partia Demokratike Shqiptare, duke i realizuar pikat ekonomike të Programit të saj, në vitin 2007 (gazeta zyrtare e R.M. nr. 79 e datës 25 qershor 2007) ia imponoi partnerit të koalicionit, që të realizohet projekti për Zonën e Lirë Ekonomike në Tetovë, që planifikohej të ishte impuls i fortë për zhvillim ekonomik të rajonit dhe hapjen e mbi 10.000 vendeve të reja të punës. Kjo zonë përfshinte një sipërfaqe prej 96 hektarëve dhe ishte e lokalizuar në mes të komunave Tetovë, Zhelinë, Tearcë, Jegunovcë dhe Bërvenicë.

Partia Demokratike Shqiptare prej buxhetit për vitin 2008, arriti të ndajë 2.5 milion euro, mjete të destinuar për ndërtimin e infrastrukturës të këtij projekti. Me daljen e Partisë Demokratike Shqiptare nga pushteti, jo vetëm që nuk u realizua ky projekt, por, u ridestinuan mjetet për programin famoz të qeverisë “për Maqedoni më të mirë”.

Sa u përket zonave të lira ekonomike, Partia Demokratike Shqiptare garanton se me ardhjen në pushtet do të mundësojë:

1. Vënien në funksion të Zonës së Lirë Ekonomike në Tetovë me investime shtese;
2. Zgjerimin e Zonës së Lirë Ekonomike në Tetovë me zona anekse në rajonin Tetovë-Jazhincë dhe Gostivar;
3. Vënien në funksion të zonës së lirë ekonomike në Strugë;
4. Themelimin e zonës së lirë ekonomike në Saraj.

C. Politikat në funksion të zhvillimit të sektorit të biznesit

1. Nxitja dhe mbështetja e sektorit të biznesit

Politikat ekonomike mund të jenë shumë të mira, por, nëse ato nuk janë të pranuar nga ana e biznesit si të tilla, nuk vlejné. PDSH-ja e kupton këtë dhe dëshiron të jetë partner me sektorin e biznesit gjatë përpilimit dhe aprovimit të politikave në fjalë, sepse biznesi e din çka është e dobishme për ata. Ne do të kemi rezultate të shkëlqyeshme nëse i respektojmë kërkesat e biznesit, i cili në shkencat ekonomike llogaritet si zemra e zhvillimit ekonomik të një vendi. Në moment kur politikat ekonomike do të jenë në kundërshtim me perceptimet e biznesit, zhvillimi ekonomik do të dështojë. PDSH-ja e kupton këtë koncept prandaj ajo do të trajtojë biznesin si partner të saj. Gjithashtu,

ne kuptojmë se ngarkesa e tepërt e biznesit me tatim dhe procedura administrative të tepërta nënkupton më pak para për biznesin gjë që çon në më pak para për investime dhe vende të reja të punës. Si masa të politikave ekonomike të cilat do të jenë në funksion të ngritjes së konkurrencës së biznesit aktual dhe hapjen e bizneseve të reja PDSH-ja propozon masa konkrete si vijojn:

1. Në përpilimin e politikës ekonomike e cila do të jetë në funksion të përforcimit të bizneseve aktuale dhe hapjen e bizneseve të reja;
2. Shkurtimin e procedurave dhe regjistrim elektronik të biznesit;
3. Revidimin dhe përpilimin e ligjit të “Shoqërisë Tregtare” , në bashkpunim me partnerin e saj biznesin, ku do të mundësojmë themelimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar vetëm me 1 EURO kapital;
4. Akreditimi ndërkombëtar i agjencionit për pagesë nacionale dhe përforcimi i sistemit për përgatitje dhe implementim të projekteve nga ndihmat e fondeve të EU-së për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;
5. Lirimi nga tatimi në fitim për 50% të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme që janë të orientuara në eksport;
6. Lirimi nga dogana i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në importin e repromatrialeve nëse ato janë të destinuara për eksport;
7. Subvencionim në lartësi prej 50% i shpenzimeve për themelimin e 20 biznes inkubatorëve për fillimin e bizneseve të vogla dhe të mesme;
8. Financimin e studimeve specialiste në Universitet në lëmitë e menaxhmentit dhe marketingut të biznesit të vogël;
9. Ngritjen Administrative të Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore në nivel të barabart me OE-në të Maqedonisë dhe përkrahjen e saj profesionale në organizimin e biznesit dhe partnerizimin e saj me qeverinë dhe institucionet tjera.

D. Zhvillimi i agrobiznesit dhe industrisë ushqimore

Bujqësia është një prej sektoreve të rëndësishme në ekonomin e një vendi, e cila zgjedh çështjen sociale të një vendi, punëson një pjesë të madhe të fuqisë punëtore. Ajo merr pjesë me 16% në BPV (Bruto Prodhimin Vendor). Sipërfaqet ku zhvillohet kjo veprimtari, përfshijnë 41% të teritorit të gjithëmbareshëm të vendit (sipërfaqja me toka bujqësore). Megjithëse vendi ka kushte të mira klimatike dhe potencial të mjaftueshëm për zhvillimin e këtij sektori, bujqësinë në vendin tonë e përcjelin disa problem të cilat e limitojn zhvillimin e kësaj veprimtarie si që janë:

1. Mungesë të infrastrukturës në zonat ku ajo zhvillohet në viset rurale,
2. Parcijalizimi i tokave bujqësore (Numri i madhë i parcelave, si rezultat i mos zgjedhjes të çështjeve trashigimore).
3. Kreditimi i pa mjaftueshëm dhe niveli i lart i kamatave në bujqësi.
4. Sistemet e ujitjes në gjendje të mjerueshme si dhe mos ngritjen e sistemeve të reja.
5. Shërbimet e dobëta dhe jo efikase në sistemin e këshillave bujqësore nga ana e shtetit.
6. Mos organizimi i bujqëve në shoqata dhe kooperativa, (organizimi mjaft i dobët ose fare nuk ekziston).
7. Mungesa e organizuar e grumbullimit të prodhimeve bujqësore (mos ekzistimit të pikave grubulluese të prodhimeve bujqësore).
8. Mungesa e laboratoreve si në prodhimtarinë primare ashtu edhe të kontrollit dhe cilësinë e përpunimit të prodhimeve bujqësore. (qumështi, mishi, etj)
9. Kostoja e lartë e prodhimit të produkteve bujqësore, si rezultat i mosplotësimit të këtyre kriterëve që ulin nivelin e konkurrencës në krahasim me produkte të importuara.

Duke patur parasysh të gjithë këto anomali prodhuesin shqiptar e pret edhe një varg problemesh të tjera në aspektin informativ dhe administrativ, në mos dhënien e këshillave, në fazën e aplikimit (mbushjen e formularëve) në subvencione, aplikimin në programin për zhvillim rural si dhe në programet e IPARD.

Investimeve kapitale në sferën e bujqësisë, kryesisht investimet që lidhen me sistemet e ujitjes dhe infrastrukturën tjetër bujqësore, arrijnë zero përqind. Përkatësisht, këto investime alokohen kryesisht në pjesën e tokave bujqësore, të banushme nga komuniteti maqedon. Shkëmbimi tregtar i prodhimeve bujqësore në Maqedoni është negative, ku dominon importi i prodhimeve bujqësore.

Duke patur parasysh problemet me të cilat ballafaqohet prodhimtaria bujqësore në Maqedoni, me ardhjen në pushtet të Partisë Demokratike Shqiptare do të angazhohemi dhe realizojmë këto prioritete:

1. Ndarja e buxhetit sipas numrit të popullsisë që jeton në Maqedoni.
2. Ndarja e subvencioneve sipas përqindjes së popullsisë, rritja e numrit të shfrytëzuesve shqiptarë në programin për zhvillim rural dhe ipard.
3. Organizimi i grumbullimit të prodhimeve bujqësore duke sjellur investitor të jashtëm si dhe ndërtimi i kapaciteteve për grumbullimin e tyre.
4. Ndërtimi i infrastrukturës në viset rurale nëpërmjet të programit për zhvillim rural. Ndërtimi do të bëhet në teritorin e Tetovës, Kumanovës dhe Strugës.
5. Ndërtimi, riparimi i sistemeve të ujitjes, mjetet do të sigurohen nga buxheti si dhe nga kredite nga Banka Botërore.
6. Ndërtimi dhe pajisja e laboratoreve për kontrollimin e ushqimit në viset ku jetojnë shqiptarët, (kontrollimin e prodhimeve bimore, qumështit dhe prodhimeve të qumështit, mishit, etj.)
7. Dhënia e tokës shtetërore prodhuesëve bujqësore, (shqiptar), si dhe revizioni i kontratave të lidhura në kundërshtim me ligjin për tokën bujqësore shtetërore.
8. Rritja e numrit të punësuarve shqiptar në ministrinë e bujqësisë, agjencionin për finansim në bujqësi dhe zhvillim rural. Agjencion për ushqim dhe veterinë, agjencionin për inicim dhe zhvillim në bujqësi.

E. Infrastruktura si parakusht i rritjes së konkurrencës dhe mbështetjes së komunitetit të biznesit

Duke pasur parasysh faktin se për zhvillim ekonomik është e nevojshme infrastruktura publike, Partia Demokratike Shqiptare në saje të analizave objektive konstaton se niveli i tanishëm i zhvillimit të infrastrukturës publike në Republikën e Maqedonisë e me theks të vecant në rajonet e banuara me shqiptarë, ofron kushte vetëm për nevojat elementare të popullsisë dhe ekonomisë në Maqedonië-Veriperendimore. Analizat komparative tregojnë se cilësia e rrugëve magjistrale, rajonale, lokale nga njëra anë dhe vëllimi i trafikut nga ana tjetër, e rrisin koston e shpenzimeve të transportit të njerëzve, mallrave, kapitalit në vlera mbi 60% sesa në rrethana normale. Duke patur parasysh varshmërinë ekonomike të Maqedonisë nga rajoni, analizat flasin se momentalisht Maqedonia ka bërë vetëm disa hapa në drejtim të korridoreve paneuropiane dhe se gjatë tre viteve të kaluara rëndësi i është kushtuar Korridorit 10-të (Selanik-Veles-Shkup-Nish-Beograd) në ndërtimin e autostradës Tabanovcë-Kumanovë dhe Demir Kapi-Smokvnicë në vlerë prej 310 milion euro dhe nuk është bërë as një Euro investim në korridorin 8-të (Varna, Burgas, Dimitrovgrad, Sofje, Mansatir, Shkup, Tiranë, Durrës) që është i një rëndësie të veçant për vendbanimet shqiptare. Gjithashtu, janë realizu projekte kapital infrastrukture në kuptim të lidhjes së teritoreve me shumicë maqedonase dhe janë lënë anësh lidhjet me rrugë cilësore të rajoneve me shumicë shqiptare. Në favor të këtij argumenti janë projektet infrastrukture si vijon: a) Rruga Izvor-Oher në vlerë prej 450 milion euro, rruga Milladinovci-Shtip në vlerë prej 306.2 milion euro, rruga Shtip-Radovish në vlerë prej 64 milion euro, rruga Shtip-Kocani në vlerë prej 534 milion euro, rruga Kocani-Deve Bari në vlerë prej 83 milion euro, hekurudha Kriva Pallankë - Deve Bari në vlerë prej 300 milion Euro, Poashtu, në sferën e energjetikës me nivelin ekzistues teknologjik të kapaciteteve të instaluara si dhe mungesa e investimeve në sferën e energjetikës ngarkojnë dhe më shumë buxhetin e familjeve si dhe vështërojnë ekonominë vendore. Telekomunikacioni, edhe pse nga aspekti juridik duket i çliruar nga monopoli shtetëror, megjithatë nuk arrin të ofroj shërbime cilësore dhe krahasuar me vendet e rajonit, çmimet e shërbimeve të telekomunikacionit janë shumë të larta. Poashtu, do të silltet vendim për

evidim të tërësishëm të projekteve ”SHKUPI 2014”, si një projekt monoetnik dhe monofetar si dhe do të silltet vendim për ndërprerje të punimeve në këtë projekt dhe realokim të mjeteve në investime cilësore kapitale. Investimet shtese që kanë kalu

Duke patur parasysh gjendjene tanishme të infrastrukturës publike në vendbanimet shqiptare dhe rëndësinë që ka infrastruktura publike në zhvillimin ekonomik, Partia Demokratike Shiptare siguron:

1. Finansim në vlerë prej së paku 35% të mjeteve buxhetore në investimet kapitale nëpër vendbanimet shqiptare;
2. Vazhdim i projektit për ndërtimin e Korridorit 8-të si një ndër projektet më fundamentale në drejtim të korridoreve paneuropiane. Do të punohet në mënyrë intensive në përfundimin e projekteve të Korridorit 8 Gostivar – Strugë-Qafë Thanë (kufiri me Shqipërinë).
3. Ndërtimi i infrastrukturës hekurudhore nga Kërçova deri në kufi me Shqipërinë përmes sigurimit të mjetve përmes fondeve IPA;
4. Finansimi i projekteve për gasifikimin e vendbanimeve në Maqedoninë perendimore;
5. Qeveria e Maqedonisë, përmes Ministrisë për transport dhe lidhje do të financojë dokumentacionin teknik për gasifikimin e vendbanimeve në Maqedoninë perendimore me çka do të krijohen kushte që gazi natyror të arrij edhe në vendbanimet shqiptare me ç’ka do të ulët kostoja e harxhimeve për qytetaret si dhe të mundësojë një zhvillim më të madh ekonomik në këto rajone. Projekt dhe finansim të gazës jellsit që do të kalon përmes lagjeve shqiptare të Shkupit, Vizbeg, Saraj, Tetovë, Gostivar, Kërçovë, Strugë gjatë 4 viteve duke hartuar dokumentacionin projektues dhe teknik;
6. Urbanizim i tokës ndërtimore në komunat: Likovë, Kumanovë, Haracinë, Çair, Saraj, Studenican, Tetovë, Zhelinë, Tetovë, Tearcë, Bërvenicë, Vrapçisht, Gostivar, Mavrovë, Kërçovë, Dibër, Strugë, Dollnen me qëllim të ndërtimit ofrimit të mundësive për ndërtim të objekteve kapitale në funksion të rritjes ekonomike si dhe zhvillimit ekonomik lokal në këto komuna;
7. Zvogëlim për 30% të shërbimeve në sferën e telekomunikimeve;
8. Reduktim i çmimit të kartonit të gjelbërt në 1 euro;

9. Hapja dhe funksionimi i vendkalimit kufitar Llojan-Miratoc që lidh Komunën e Likovës me Luginën e Preshevës dhe Bellanoc-Stancic (ekziston vendim nga koha e qeverisjes së PDSH-së dhe këto vite nuk është bërë asnjë veprim konkret në drejtim të fillimit të punimeve.
10. Ndërtim të rrjetit të ujësjellsit në vendbanimet e Likovës me grant nga qeveria në vlerë prej 10 milion euro. Përfundim i projektit për 30 muaj me ç'ka do të zgjidheshte përfundimisht çështja me ujin e pijshëm në vendbanimet e Komunës së Likovës;
11. Ndërtimi i banesave sociale dhe banesave për çiftet e reja në qytetin e Kumanovës
12. Lidhja e fshatrave të Likovës me Haraçinën është e një rëndësie të veçant duke patur parasysh lidhjen gjeografike të këtyre vendbanimeve me cka do të mundësoheshte zhvillim ekonomik i fshatrave të Karadakut
13. Finansimi i planave urbanistike për fshatrat e rajonit të Likovës – Sjellja e vendimit të Qeverisë për financimin e hartimit të planeve detale urbanistike për të gjitha vendbanimet e Komunës së Likovës,
14. Ndërtimi i zonës industriale me infrastrukturë përcjellëse në Likovë, është projekt i një rëndësie të veçant për zhvillimin ekonomik të rajonit të Likovës. PDSH, do të sjell vendim në qeveri për ndarjen e 2 milion eurove për rregullimin e çështjeve pronëso-ro-juridike dhe rregullimin e infrastrukturës përcjellëse.
15. Investime në infrastrukturën rrugore në fshatrat e Komunës së Haraçinës si dhe rregullimi i tërsishëm i rrugës Hasanbeg–Haraçinë dhe Nikushtak-Haraçinë.
16. Urbanizimi i tërsishëm i lagjeve të Çairit, Dizhonit, Seravës, Duqanxhikut, Topanës, dhe rregullimi i infrastrukturës në Gazi Babë-Do të sillte vendim në qeveri për financimin e hartimit të planeve detale urbanistike për këto lagje, më pas pas zgjedhjeve të çështjeve pronëso-ro-juridike përmes partneritetit publiko-privat do të investohet në urbanizimin e tërësishëm të këtyre lagjeve,
17. Ndërtimi i banesave sociale dhe banesave për çiftet e reja bashkëshortore në Çair me mjete të qeverisë si dhe përmes partneritetit publiko-privat-
18. Modernizimi i tërsishëm i lagjeve të Komunës së Çairit-në kontunitet për 4 vite;

19. Ndërtimi i infrastrukturës dhe modernizim i tërsishëm i zonës ekonomike në Vizbeg-
20. Rregullimi i rrugës për në fshatin Luboten
21. Rekonstruim i tërsishëm i rrugës Draçevë-Studeničan si dhe rekonstruimi i tërsishëm i rrugëve në vendbanimet e Karshiakës, Studeničanit, Batincës, Moranës, Seta Petkës, Crni Vrh
22. Rregullim i rrugëve në fshatrat e Lisit të madh-
23. Ndërtimi i rrjetit regjional të ujësjellësit në fshatrat e Karshiakës dhe kyçja e tyre në rrjetin e ujësjellësit të Seta Petkës-
24. Urbanizimi i tërsishëm i Lagjes Nerez dhe rregullimi i infrastrukturës në Nerez të epërm-
25. Rekonstruimi i rrugëve në fshatrat e komunës së Sarajit, ndërtimi i rrjeteve të ujësjellësit në fshatrat e komunës së Sarajit-
26. Rregullimi i tërsishëm i infrastrukturës në zonën industriale në Saraj-
27. Sjellja e vendimit të qeverisë në afat prej 6 muaj për kalimin në pronësi të komunës së Sarajit të qendrës rekreative "Saraj" dhe "Matka";
28. Krijimi i strategjisë për zhvillimin e turizmit në fshatrat e komunës së Sarajit-
29. Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësve dhe rrjetit të kanalizimit në vendbanimet e Dërventit dhe rregullimi i tërsishëm i rrugëve në këto vendbanime-
30. Ngritja e infrastrukturës përcjellëse dhe ngritja e Zhelinës në qendër rajonale-
31. Jetësimi dhe funksionimi i zonës së teknologjiko-industriale në Tetovë-
32. Përfundimi i ujësjellësit të Tetovës. Qeveria e Maqedonisë gjatë vitit 2011-2013 ndau 0% mjete për këtë projekt. PDSH-ja do të angazhohet që gjatë vitit 2017 të përfundojë tërësisht projektin e ndërtimit të ujësjellësit të Tetovës;
33. Përpilim i fizibilitetit studimit për ndërtimin e ujësjellësit rajonal (ujërat e Sharrit-2017);
34. Përpilimi i projektit kryesor dhe fillimi i ndërtimit të rrugës Tetovë-Prizren, si një rrugë e rëndësishme së veçantë me ç'ka dukshëm do të

- reduktohet largësia me Kosovën si dhe do të kishte impakt në zhvillimin ekonomik të vanbanimeve të rajonit të Sharrit-
35. Modernizimi i rrugës regjionale Tetovë-Jazhincë-
 36. Riparimi tërësishëm dhe vënja në funksion e teleferikut Tetovë-Kodra e Diellit, me qëllim të ritjes dhe zhvillimit të turizmit
 37. Përpilimi i planit të ri urbanistik për Kodrën e Diellit dhe tërëhëkja e investitorëve të huaj dhe të vendit në drejtim të zhvillimit të turizmit-
 38. Hartimi i projektit kryesor urbanistik për kazermën e Tetovës dhe transformimim e saj në qendër banimi, komerciale, arsimit, shëndetësie;
 39. Hapja e bulevardëve të reja në Tetovë-
 40. Finansim i projektit të ri të sheshit të Tetovës dhe shëndrimi i sheshit në ambient atraktiv për qytetarët-
 41. Shëndërimi i lokalitetit “Banjiçe” në qendër rekreative bashkëkohore-
 42. Ndërtimi i banesave sociale dhe banesave për çiftet e reja në qytetin e Tetovës-në kontinuitet brenda 4 viteve;
 43. Rekonstruim i tërësishëm i rrugës regjionale Tetovë-Vrapçisht-
 44. Funksionimi i zonës industriale “Leska” në komunën e Bërvenicës-
 45. Ndërtimi i zonës industriale në lokalitetin “Rudina” në Çegran-
 46. Ndërtimi dhe funksionimi i qendrës për grumbullimin e produkteve bujqësore në komunën e Negotinës
 47. Ndërtimi banesave sociale në komunën e Gostivarit-në kontinuitet gjatë 4 viteve;
 48. Krijimi i zonës industriale në mes fshatrave Debresh dhe Zubovcë-mbrenda 4 viteve;
 49. Rekonstruim i tërësishëm i rrugës për në Llakavicë-
 50. Zgjedhja e problemit me ujën e pijshëm në qytetin e Gostivarit-viti 2017;
 51. Rikonstruim i tërësishëm i rrugës për në Banjiçë-
 52. Përfundim i tërësishëm i rrugës Mavrovë-Dibër-
 53. Urbanizim i tërësishëm i lagjeve shqiptare në komunën e Kërçovës-në kontinuitet brenda 4 viteve;
 54. Zhvillimi i turizmit malor në vendbanimet e Mavrovës dhe fshatrave të Zhupës -në kontinuitet brenda 4 viteve;
 55. Përfundimi i punimeve në rrugën regjionale Dibër-Bllato-viti 2016;

56. Investime ne Liqenin e Dibrës, me qëllim të krijimit të kushteve për zhvillim të turizmit - në kontinuitet brenda 4 viteve;
57. Investime në infrastrukturën e fshatrave të Resnjës, në Gërçari, Asamati me qëllim të zhvillimit të turizmit në liqenin e Prespës-në kontinuitet brenda 4 vitevet;
58. Investime në plazhet e Strugës-në kontinuitet brenda 4 vitevet;
59. Finansim në infrastrukturën e qytetit të Strugës dhe sanim i tërësishëm i rrugëve në qytet-në kontinuitet brenda 4 vitevet;
60. Krijimi i zonës industriale në Veleshtë, rregullimin e çështjeve pronëso-ro-juridike si dhe sjellja e vendimit në qeveri për financim të dokumentacionit teknik;
61. Rikonstruimi i tërësisishëm i rrugës Strugë-Qafë Thanë, në kuadër të Korridorit 8;
62. Investime në infrastrukturën e fshatrave Belicë, Ladorishtë, Livadhi, Frëngovë. (brenda 4 viteve);
63. Urbanizimi i lagjeve shqiptare në Ohër-fillimi i punimeve viti 2017;
64. Investime në lagjet shqiptare të Manastirit-fillimi i punimeve, viti 2017;
65. Investime infrastrukturore në Bistricë-fillimi i punimeve në vitin 2017;
66. Investime në Krushevë-në kontinuitet brenda 4 viteve;
67. Investime në rrugë, ujësjellës, kanalizime në fshatrat e Dollnenit-fillimi i punimeve në vitin 2017 dhe vazhdim i projekteve në kontinuitet;
68. Investime në Buzallkovë në ndërtimin e rrugëve dhe rrjetit të ujësjellësit; fillimi i punimeve në vitin 2017 dhe vazhdim i projekteve në kontinuitet
69. Hartimi i projektit dhe financimi në ndërtimin e rrugës Karshiakë-Buzallkovë-Jabollçisht- si një projekt i një rëndësie të veçant, me çka do të mundësohet lidhja e vendbanimeve shqiptare të rajonit të Pellagonisë dhe lidhja e tyre me qytetin e Shkupit.
70. Ndërtimi i objekteve të reja shkollore, për shkolla fillore dhe të mesme si dhe rivitalizimi dhe modernizimi i shkollave ekzistuese
71. Ndërtimi i qendrave të reja spitalore të shëndetësisë primare dhe sekondare dhe rikonstruim i qendrave ekzistuese spitalore.
72. Themelim të zonës së lirë ekonomike në Saraj

73. Ndërtim të sallave sportive në fshatrat shqiptare
74. Rikonstruim, mirëmbajtje dhe përmirësim të rrjeteve të ujësjellësve në zonat shqiptare
75. Rikonstruim, mirëmbajtje dhe përmirësim të rrugëve lokale dhe rajonale që lidhin vendbanime shqiptare.
76. Ndërtim dhe rikonstruim të kanaleve për ujitje të tokës bujqësore të rajoneve shqiptare

F. Zhvillimi i turizmit

Në vendet e zhvilluara, por, edhe ne shtetet në zhvillim e sipër, turizmi paraqet një veprimtari shumë të rëndësishme ekonomike. Mundëson krijimin e vendeve të reja të punës, përmirësimin e imazhit të vendit dhe ka një ndikim të rëndësishëm si në aspektin ekonomik ashtu edhe në aspektin ekologjik, social dhe kulturor. Edhe në rajonin e Maqedonisë Veriperëndimore turizmi është degë e rëndësishme ekonomike. Mirëpo, potenciali turistik i këtij rajoni ende mbetet i pashfrytëzuar sa duhet. Planifikimi cilësor i hapësirës është një ndër parakushtet më të rëndësishme për zhvillimin afatgjatë dhe të qëndrueshëm të turizmit në rajonin e Maqedonisë Veriperëndimore.

Për zhvillim të qëndrueshëm turistik, Partia Demokratike Shqiptare garanton se me ardhjen në pushtet, do të mundësojë:

1. Krijimin e një strategjie të zhvillimit afatgjatë turistik;
2. Ngritjen e kapaciteteve hotelerike, duke lehtësuar investimet e jashtme;
3. Krijimin e kushteve për rritje të numrit të turistëve;
4. Ndërtimin e një imazhi turistik të mirëfilltë, i dëmtuar si pasojë e konfliktit;
5. Konkurrencë të mirëfilltë në menaxhimin e sektorit hotelerik në ekonominë e tregut, me qëllim të përmirësimit të ofertës turistike;
6. Organizim dhe udhëheqje efikase të politikës turistike në nivel të vendit;
7. Koordinim të strategjive në ofertën turistike;
8. Rregullimin e planit hapësinor;
9. Edukimin dhe trajnimin e kuadrit menaxhues dhe zhvillimin e sistemit menaxhues në ndërmarrjet turistike dhe hoteliere;
10. Krijimin e infrastrukturës së nevojshme (përmbajtjet rekreative);
11. Eliminimin e problemeve gjatë furnizimit me energji, ujë dhe kanalizimin e ujërave të zeza dhe hedhurinat;
12. Rruajtjen e natyrës dhe qendrave urbane nga ndërtimet ilegale;
13. Lehtësimi i kalimit të kufirit (lidhjet rrugore përmes kufirit, kartoni i gjelbër), që do të ndikojë në rritjen e tregut;

14. Nxitjen e zhvillimit të rajoneve turistike me mundësi më të volitshme për zgjatjen maksimale të sezonit turistik dhe rritja e shkallës së shfrytëzimit të kapaciteteve të ofertës turistike;
15. Zhillimin e bashkëpunimit me operatorë turistikë të jashtëm;
16. Respektimin e standarteve ekologjike, që do të mundësojnë mbrojtjen efikase të resurseve natyrore.

G. Ekologjia

Një nga të drejtat e garantuara kushtetuese të qytetarëve është e drejta e mjedisit të shëndoshë. Por, në kushte të modernizimit dhe zhvillimit të hovshëm teknologjik dhe shoqëror, ndryshimet klimatike, sëmundjet e ndërlikuara, tharja, vërshimet, debalanset natyrore, zhdukja e familjeve biologjike, janë vetëm një pjesë e ndikimeve negative të njeriut ndaj mjedisit jetësor.

Prandaj, në aktivitetet e bashkësisë në vazhdimësi do të angazhohemi që me kujdes ta shfrytëzojmë hapësirën fizike dhe resurset natyrore si dhe sigurimin e kushteve për zhvillim të qëndrueshëm si dhe realizimin e të drejtave dhe obligimeve të qytetarëve për mjedis të shëndoshë.

Prioritet:

1. Mbrojtja dhe përparimi i mjedisit jetësor nëpërmjet të arritjes së qëllimeve të parapara me strategjitë dhe planet hapsinore të sjellura;
2. Integrimi i politikave për mjedis jetësor dhe planifikim hapësinor në politikat e tjera sektoriale;
3. Planifikimi dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i hapësirës dhe pasurive natyrore;
4. Arritja e standardeve evropiane për kualitet të mjedisit jetësor, natyres dhe zhvillim të qëndrueshëm nëpërmjet të zbatimit të legjisllacionit;
5. Sigurimi i informatave për mjedis jetësor, natyrën dhe hapësirën si dhe qasje e opinionit publik deri te ato, pjesëmarrja e publikut në sjelljen e vendimeve në fushën e mjedisit jetësor dhe pjesëmarrje aktive në sistemet ndërkombëtare për mjedis jetësor, natyrën, hapësirën.

6. Ngritja e vetëdijes publike dhe edukimi i publikut për të drejtat dhe obligimet sa i përket mjedisit jetësor, natyrës dhe hapësirës, nëpërmjet të tribunave, anketave, trajnimeve, seminareve si dhe publikimeve të broshurave;
7. Zhvillimi i kapaciteteve institucionale dhe administrative në funksion të mbrojtjes së mjedisit jetësor, natyrës dhe hapësirës;
8. Rritja e shkallës së investimeve në fushën e mjedisit jetësor
9. Ndryshimet klimatike
10. Aproximimi i legjislacionit nacional me atë të Bashkësisë Evropiane;
11. Sistem informativ për monitorimin e kualitetit të ujit, ajrit dhe të gjitha elementve tjera radioaktive;
12. Pyllëzim në rajonet e Kumanovës, Likovës, Shkupit, Tetovës, Gostivarit, Dibrës, Strugës dhe Prilepit.
13. Stacion filtrimi i ujërave të zeza në qytetin e Tetovës;
14. Mbështetje financiare të projekteve për menaxhim me mbeturina mjekësore në qendrat spitalore dhe klinike dhe atë në: Kumanovë, Shkup, Tetovë, Gostivar, Kercov, Dibër dhe Strugë.

i. Mbështetja e planeve lokale aksionare për mjedis jetësor (PLAMJ)

Qëllimi i mbështetjes së këtyre planeve për komunat ka një rëndësi jashtzakonisht të madhe sepse nëpërmjet planeve aksionale arrihen tre objektiva: mbrojtja e shëndetit të qytetarëve, zhvillimi i mjedisit jetësor, si dhe mbrojtje dhe qëndrueshmëri të resurseve natyrore.

a) *Menaxhimi me mbeturina*

Përpiluar strategjinë për menaxhime me mbeturina, me të cilën kemi detektuar të gjitha deponitë e egra. Në rajonin e Pollogut do të ndërtohet deponia regjionale me të gjitha standardet (me mundësi shfrytëzimi të mbetjeve materiale, përmes riciklimit, kompostimit dhe energjisë alternative).

1. Selektimi i mbeturinave nga burimi i krijimit
2. Krijimi i vendeve për riciklim të mbeturinave
3. Mbulimi i tërë rajoneve për grumbullimin e mbeturinave

4. Ndërtimi i deponisë sipas standardeve evropiane (investime vendore)
5. Pastrimin e deponive të egra
6. Krijimi i sistemit të integruar në menaxhimin me mbeturina

b) Menaxhimi me ajrin

1. Me qëllim parandalimin dhe kontrollimin e saktë të ndotjes së ajrit nga industritë e rënda, termoelektranët, transportit dhe djegies së mbeturinave do të realizojmë:
2. Strategji dhe planprograme që do të kontribuojnë në mbrojtjen dhe përmirësimin e kualitetit të ajrit;
3. Përpilimi i projektit për gasifikimin e amvisërisë në qytetin e Tetovës dhe Gostivarit
4. Plan nacional për mbrojtje nga katastrofat natyrore.
5. c.Administrimi me ujërat
6. Çështjet si: mungesa e ujit, ruajtja dhe menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve ujore konsiderohen sot si një ndër problemet më të mëdha globale mjedisore.
7. Resurset ujore kanë rëndësi shumë të madhe për jetën dhe ekonominë e njeriut dhe janë burim kryesor i plotësimit të nevojave për ujë të pijshëm, për ujitjen e tokave dhe për industri.
8. Kur kemi parasysh faktin se Maqedonia perëndimore ka resurse të mjaftueshme ujore, ne duhet të pranojmë se mbrojtja, ruajtja dhe monitorimi i cilësisë së tyre është njëra prej sfidave më të mëdha mjedisore para shoqërisë sonë. Por, duhet pranuar faktin se menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve ujore, mbrojtja e ujërave dhe përmirësimi i cilësisë së ujërave kërkojnë përkushtim të veçantë nga të gjithë faktorët përgjegjës.
9. Në kuadër të aktiviteteve në sektorin e ujërave, PDSH-ja, do të vazhdojë angazhimin e saj në përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm, në rregullimin e shtretërve të lumenjve si dhe në menaxhimin e ujërave të zeza. Në veçanti, do të angazhohemi në plotësimin e infrastrukturës ligjore dhe harmonizimin e saj me direktivat e Bashkimit Evropian.

10. Natyrisht se edhe në Maqedoni këto probleme janë evidente, andaj ne si PDSH, këto çështje i kemi vendosur në mesin e prioriteteve të punës dhe të angazhimit tonë.
11. Ndër prioritetet më të rëndësishme do të jenë:
12. Vendosja e çështjes së administrimit të ujrave ndër prioritetet e Qeverisë;
13. Plotësimi dhe përmirësimi i legjislacionit për ujëra dhe zbatimi i tij;
14. Themelimi i një Instituti apo Drejtorie të veçantë për ujëra;
15. Krijimi i Autoriteteve rajonale të pellgjeve lumore;
16. Ritja e bashkëpunimit të gjitha institucioneve përgjegjëse në sektorin e ujërave
17. Delegimi i disa kompetencave komunave;
18. Ndërtimi i hidrocentraleve të vogla në pjesën perëndimore të maqedonisë;
19. Mbrojtja e ujrave sipërfaqësore dhe atyre nëntokësore (burimeve, lumenjve, liqeneve natyrale, liqeneve artificiale, etj.);
20. Mbrojtja e Radikes
21. Rehabilitimi i sistemeve për ujitje;
22. Mbrojtja nga vërshimet;
23. Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujërave të zeza në Maqedoninë perëndimore;
24. Vetëdijsimi i publikut për gjendjen e ujërave;
25. Ndërprerja e shfrytëzimit ilegal të ujit;
26. Fillimi i bashkëpunimit ndërkufitar në lidhje me ujërat e përbashkëta me Republikën e Kosovës (lumi Lepenc) në drejtim të përgatitjeve të Planeve për administrim të pellgjeve ujore (sipas Ligjit të ujrave dhe Direktivave të Unionit Europian.
27. Zgjerimi i bashkëpunimit kufitar me Republikën e Shqipërisë (Liqeni i Ohrit, Liqeni i Prespës, Lumi Drin)

ii. Programi për investime në mjedisin jetësor
Përkrahje financiare nëpërmjet programit për investime në mjedisin jetësor për organizatat joqeveritare, komunat, shoqatat ekologjike, nëpërmjet këtij programi do bëhen edhe investime dhe rregullime të kanalizimeve dhe ujësjellësve, financohen aktivitete për ngritjen e vetedijes publike për mjedisin jetësor si dhe përgatitja e dokumentacioneve dhe projekteve për

mbrojtjen e mjedisit jetësor. Nëpërmjet të këtij programi do të shpërndahen mjete financiare për këto qëllime:

1. Realizimin e projekteve dhe aktiviteteve për pastrimin e deponive të egra;
2. Përpunimi i planeve aksionare lokale për mbrojtjen e mjedisit jetësor;
3. Përpunimi i dokumentacioneve teknike për realizimin e projekteve dhe aktiviteteve për mbrojtjen dhe përmisimin e kualitetit të ujërave dhe realizimin e projekteve për mbrojtjen e natyres dhe ruajtjen e llojllojshmërisë së biologjike;
4. Nxitje e programeve dhe projekteve edukative dhe hulumtuese dhe studime zhvillimore për mbrojtjen e mjedisit jetësor si dhe përkrahje e projekteve dhe aktiviteteve të organizatave joqeveritare të formuara për mbrojtjen e mjedisit jetësor;
5. Realizimi i projekteve për ngritjen e vetëdijes publike, edukime dhe trajnime në fushën e mjedisit jetësor.

ARSIMI

Partia Demokratike Shqiptare, arsimin e vlerëson si segment tejet të rëndësishëm. Arsimi, mes tjerash, paraqet platformën ku formohet dhe zhvillohet mendimi intelektual i një shoqërie. Nëpërkëmbja e arsimit ka çmim shumë të lartë për një komb, pasi pasojat janë afatgjate. Prej këtu buron edhe shqetësimi i madh i PDSH-së për diskriminimin dhe nëpërkëmbjen e arsimit në gjuhën shqipe në Maqedoni.

A. Gjendja aktuale

Arsimi në Maqedoni në përgjithësi, por edhe ai në gjuhën shqipe, është bërë objekt i eksperimenteve të vazhdueshme, të cilat qeveria aktuale po i zbaton në emër të reformave. Kurse reformat nuk paraqesin ngjarje, por procese të ndryshimeve. Këto procese, për fat të keq, nuk iniciohen dhe nuk orientohen prej shkollave dhe prej universiteteve ku në fakt bëhen ndryshimet e vërteta, por imponohen me akte ligjore. Nga ana tjetër, ndryshimet në arsim dhe në shkencë duhet të harmonizohen me projeksionet për zhvillimin e tregut. Përkufizimi i ndryshimeve në arsim dhe strategjia e zhvillimit duhet të harmonizohen në mënyre simuluese me propozimet e ekspertëve, punëdhënësve dhe sindikatës, të botës akademike, përkatësisht arsimore dhe pushtetit ekzekutiv ose ligjvënës. Mënyra se si realizohen reformat në arsim dhe efektet e tyre flasin më së miri për jo seriozitetin në qasje nga ana e pushtetit aktual.

Në kuadër të **procesit edukativ arsimor të moshës parashkollore** institucionet shtetërore: kopshtet e fëmijëve, qendrat e zhvillimit të hershëm dhe agjencitë e shërbimeve për përkujdesjen e fëmijëve të moshës parashkollore në mjediset e banuara me shqiptarë janë nën çdo standard.

Në **arsimin fillor**, po zbatohen programet e Kembrixhit edhe pse në Maqedoni parapërgatitjet e nxënësve nuk janë as të përafërta me parapërgatitjet e fëmijëve në Britaninë e Madhe. Arsimtarët tanë dhe prindërit e fëmijëve nuk qenë të gatshëm për ta përkrahur këtë ndërhyrje, por kjo nuk e shqetësoi pushtetin dhe nuk e pengoi atë ta fillojë këtë

eksperiment. Kur **arsimi i mesëm** u bë i detyrueshëm, ishte paraparë që nxënësit të informohen mirë dhe me kohë, në mënyrë që të orientohen sipas afiniteteve/shkathtësive të tyre. Kjo nuk u respektua dhe sot shkollat e shumta profesionale kanë mbetur të paplotësuara, në llogari të gjimnazeve. Sikur politikat arsimore të udhëhiqeshin nga analizat e tregut të punës dhe nxënësve t'u ishte prezantuar drejt interesi i këtij tregu, të rinjtë me siguri do të kishin zgjedhur profesionin që u siguron punë.

Reformat në **arsimin e lartë** filluan me përkrahjen e sistemit të Bolonjës, ndryshim ky që u bë pa përgatitjet e nevojshme dhe që rezultoi me uljen e cilësisë. Kur kësaj do t'ia shtojmë faktin se dyert e universiteteve u hapën për të gjithë (sipas politikës *secili duhet të ketë mundësi të regjistrohet në universitet*) dhe faktin se shumë drejtime u disperzuan nëpër qytete e qyteza të ndryshme, pa mbajtur llogari për nivelin e kuadrit, rregullshmërinë e ligjëratave dhe ambientet ku ato realizohen, atëherë nuk habit fakti që arsimin e lartë në gjuhën shqipe në Maqedoni e karakterizojnë **ekspansioni** dhe **cilësia e ulët**. E se cilësia e ulët është evidente këtë e pranon edhe vetë pushteti me faktin që kërkon mekanizma për ta përmirësuar gjendjen. Dhe, këtë do që ta arrijë përsëri duke bërë një eksperiment. Eksperimenti *vlerësimi (testimi) ekstern* paraqet një medium për ndjelljen e frikës te stafi i mësimdhënësve të shkollave fillore dhe të mesme. Kjo mënyrë e vënies nën kontroll e mësimdhënësve duke zbatuar masën ndëshkuese dënim me ulje të të ardhurave personale, paraqet shembull tipik për heshtjen e një shtrese shumë të rëndësishme të shoqërisë. Përpjekjet për zbatimin e këtij lloji vlerësimi (*provimi shtetëror*) edhe në arsimin e lartë paraqesin ndërhyrje në autonominë e universitetit dhe dëshirë për frikësim edhe të profesorëve universitarë. Mbetet e paqartë si do të realizohet ky testim, kush do ta realizojë, si do të krahasohet nota e testimit ekstern me notën që profesori e jep duke u mbështetur në shumë faktorë (për këtë obligohet me mënyrën e studimit sipas sistemit të Bolonjës) dhe çfarë ndëshkimi parashikohet për profesorin, nota e të cilit është e ndryshme nga ajo e vlerësimit ekstern. Vendosja e profesionit të profesorit, krahas atij të mjekut dhe policit, në majën e listës së profesioneve të korruptuara është një problem më se serioz. Një çështje më vete paraqet cilësia e teksteve shkollore në gjuhën shqipe, të përpiluara sipas plan-programeve të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit, kurse në pjesën më të madhe të përkthyer nga gjuha maqedonase. Në lëndë të

caktuara, si p.sh. në tekstet e historisë dhe të muzikës janë anashkaluar temat dhe vlerat e shqiptarëve dhe kështu nxënësit nuk kanë mundësi të mësojnë mjaftueshëm për historinë dhe kulturën e popullit të vet. Tekstet përmbajnë edhe gabime të ndryshme materiale dhe në masë të madhe edhe gjuhësore.

B. Fakte

1. Infrastruktura (ka objekte që përkujtojnë mesjetën)
2. Mungesa e kopshteve për fëmijë në vendet e banuara me shqiptarë
3. Pozita e nxënësit (numri i nxënësve shqiptarë në një klasë, mjetet financiare për një kokë nxënës, çështja e mësimit tërë ditor, numri i mësimdhënësve)
4. Pozita e studentit (buxheti i arsimit të lartë nuk ndahet në mënyrë proporcionale me përqindjen e shqiptarëve)
5. Hapja e universiteteve për qëllime politike
6. Sasia e mjeteve të destinuara për shkencën dhe hulumtimet që realizohen në gjuhën shqipe

C. Vizioni i pdsh-së për politikat e arsimit

Rrugëdaljen nga kjo situatë PDSH-ja e sheh te qasja e re në këtë sferë, me veprime konkrete, si:

1. **Ndërprerja e diskriminimit** nëpërmjet realizimit të kërkesës së PDSH-së për distribucion proporcional të buxhetit;
2. **Përpilimi i strategjive afatmesme dhe afatgjate** të zhvillimit të arsimit në gjuhën shqipe;
3. **Ngritja e cilësisë** së arsimit në të gjitha nivelet

Ky do të jetë një proces i gjatë dhe gjithëpërfshirës, në të cilin do të ndërmerren hapa konkretë:

1. Seleksionimi i kandidatëve për studentë në Fakultetet që përgatitin kuadër arsimor; sigurimi i kushteve në objekte përkatëse;
2. Revidimi i plan-programeve të arsimit fillor dhe të mesëm;
3. Intervenim në ligjin ekzistues për tekstet shkollore, në mënyrë që nxënësit shqiptarë, për lëndët që kanë të bëjnë me gjuhën, historinë dhe kulturën shqiptare të mund të shfrytëzojnë libra cilësorë të botuar edhe jashtë R. së Maqedonisë;
4. Hartimi i teksteve shkollore sipas metodologjive bashkëkohore;
5. Harmonizimi i sistemit arsimor të shkollave të mesme dhe universiteteve me kërkesat e shoqërisë dhe vendosja e **parimit të diturisë** në këtë sistem – ndërprerja e praktikës së tanishme ku marrja formale e diplomës nuk korrespondon me dituritë e vërteta që duhet të arrihen në procesin edukativ arsimor;
6. Afirmimi i arsimit të mesëm profesional dhe përpilimi i strategjisë së zhvillimit të këtij arsimit në funksion të punësimit;
7. Sensibilizim i opinionit për mundësitë që i ofron arsimit joformal dhe mësimi gjatë gjithë jetës;
8. Analizë e gjendjes së drejtimeve dhe kuadrove të diplomuara në fushat përkatëse dhe akreditimi/ri-akreditimi i drejtimeve vetëm në bazë të nevojave reale të shoqërisë;
9. Kthimi i studimeve katër vjeçare në arsimin e lartë, në mënyrë që të diplomuarit të zënë vendin e duhur në tregun e punës dhe të mos vërshojnë pa nevojë ciklin e dytë të studimeve duke krijuar hiper prodhim të kuadrove me tituj shkencorë;
10. Kombinimi proporcional i teorisë dhe praktikës gjatë procesit mësimor dhe në mënyrë të veçantë gjatë atij të studimeve;
11. Revidimi i mëtejme i studimeve të disperzuara;
12. Hapja e qendrave të zhvillimit të fëmijëve me nevoja të posaçme në gjuhën shqipe.
13. Ndërprerja e testimit ekstern;
14. Stimulim financiar i kuadrit mësimor;
15. Rritja e autonomisë institucionale e universiteteve;

16. Sigurimi i modeleve të tjera të financimit të punës hulumtuese kërkimore.

Qëndrimi i pushtetit aktual për rolin dhe vlerën e arsimit në prosperitetin e shtetit mbeten vetëm në kuadër të deklaratave. Këtë më së miri e dëshmon përqindja e ulët e mjeteve të ndara nga buxheti i shtetit!

KULTURA

A. Elaborat për kulturën shqiptare

Si komponent ndër më kryesorët për një etni pa dyshim është edhe kultura. Zhvillimi kulturor i një populli reflekton vlera, të cilat bëhen themele të patundshme të mirëqenies si dhe dritë mbi perspektivën e sigurisë. Së këndejmi, duke e patur parasysh këtë fakt, Partia Demokratike Shqiptare gjatë periudhësë 2006-2008 kujdes të vecantë i kushtoi në vecanti institucionalizimit të jetës kulturore shqiptare. Shqiptarët e Maqedonisë deri në këtë kohë jetën e vet kulturore e përmbushnin me aktivitete amatoreske e gjysmëprofesionale, ndërsa brenda këtyre dy viteve, kjo jetë kulturore përjetoi atë që nuk e kishte përjetuar asnjëherë më parë në këtë nënqiell.

Për herë të parë në historikun e këtij nënqielli shqiptarët patën fat të themelojnë institucione kombëtare dhe të ndajnë buxhet për investime kapitale. Gjatë periudhës 2006-2008 u themelua Biblioteka kombëtare në Tetovë, Teatri i parë shqiptar „Teatri i Tetovës”. U themelua edhe Galeria Nacionale në Tetovë. Ministria e Kulturës në bashkpunim me Ministrinë e Arsimit themeloi Institutin për hulumtime kulturore shqiptare. U arrit 22 Nëntori, dita e Alfabetit Shqip të shpallet festë kombëtare, Bajrami i Vogël u shpall festëfetare për muslimanët kurse Bajrami i Madh u shpall festë shtetërore.

Partia Demokratike Shqiptare ndikoi, kërkoi dhe arriti që për herë të parë në historinë e jetës fetare në këtë hapësirë, nga buxheti shtetëror të ndajë para për meremetimin e Medresesë së Shkupit si dhe për mirëmbajtjen e rikonstruimin e mbi 20 xhamive. Po ashtu për herë të parë nisën edhe disa manifestime kulturore, të cilat po marrin karakterin e manifestimeve tradicionale . Ditët 22-28 Nëntor i kushtohen Manifestimit „Ditët e kulturës shqiptare”. „Shkupi fest” është festivali i parë ndërkombëtar nën patronatin e Teatrit Shqiptar në Shkup.

Në shumë aktivitete ndërkombëtare morën pjesë edhe artistë shqiptarë. Asociacionet shqiptare, ansambletë shqiptare, si dhe shumë artistë shqiptarë të vendit për herë të parë gjatë këtyre dy viteve u ndjenë të barabartë me simotrat dhe me kolegët e vet të vendit. Qendrat dheshhtëpitë kulturore që

funksionojnë nëpër vendbanimet shqiptare u subvencionuan shumëfish më shumë se sa më parë, ndërsa bibliotekat e shkollave shqiptare që patën nevojë për libra në gjuhën shqipe, pa kurfarë problemi arritën të tërheqin tituj të shumtë nga Biblioteka Universitare e Shkupit. Në fillim të vitit 2008 u themelua Qendra për Konservim me seli në Gostivar, ndërsa u nda një buxhet i konsiderueshëm për gjurmime arkeologjike në Kalanë e Tetovës, si dhe për restaurimin e saj.

PDSH-ja në kulturë përfshin këto veprimtari:

1. Veprimtarinë botuese
2. Veprimtarinë muzikore
3. Veprimtarinë e artit dramatik,
4. Filmin
5. Galerinë
6. Qendrën kulturore (Shoqerite Kulturore Artistike)
7. Veprimtarnë e ndërmjetësimi në prezentimin e veprave kulturore
8. Veprimtarinë e mbrojtjes dhe shfrytëzimit
9. Trashigiminë Kulturore
10. Operën dhe baletin

PDSH-ja do të kujdeset që buxheti i ndarë për botime të jetë sa më i madh dhe të paktën 40 për qind nga ato mjete të destinohen për botimet shqiptare. Gjithashtu, do të kujdeset që shpërndarja e mjeteve të jetë sa më e drejtë dhe proporcionale midis shtëpive botuese, pa marrë parasysh nëse ato janë anëtare të shoqatave botuese ose jo. Do të kujdeset edhe për ngritjen e kritereve përzgjedhëse të projekteve, me qëllim që këto financime të jenë vërtetë të dobishme për kulturën dhe jo shërbime “hatri” e interesash të vogla.

Gjithashtu, PDSH-ja do të kujdeset për hartimin e projekteve të mëdha, për botimin e disa kolanave të rëndësishme për kulturën shqiptare, siç mund të jetë, bie fjala, kolana e botimit të lëtersisë shqipe, ku do të përfshihen autorë nga të gjitha periudhat letrare që nga letërsia e vjetër e deri te ajo bashkëkohore, ku do t’u jepet hapësirë edhe autorëve të ekskomunikuar nga sistemi monist, si dhe të disa autorëve nga Maqedonia, veprimtaria e të cilëve ka mbetur pak e njohur për shkak të rrethanave politike a të ndonjë rrethane tjetër. Po ashtu, në kuadër të këtyre projekteve do të kujdesemi që

me një përkthim sa më cilësor dhe me një shtyp sa më luksoz t'i sjellim në shqip kryeveprat e letërsisë botërore të të gjitha periudhave, si dhe libra që i përkasin fushës së etnokulturës shqiptare. PDSH-ja në veprimtarinë muzikore dhe skeniko-artistike përfshin shfaqjen publike të veprave artistike të muzikës, dramës, operës, operetës, baletit, valleve, etj.

Në veprimtarinë dramatike Ministria e Kulturës as për së afërmi nuk ka bërë mbulimin e kërkesave financiare. Drama shqiptare pranë Teatrit Shqiptar në Shkup si dhe pranë Teatrit të Tetovës, në krahasim me dramat maqedonase, është financuar minimalisht për realizimin e projekteve.

Nga 115 institucione dhe objekte kulturore që krijojnë dhe kontribuojnë për zhvillimin e kulturës në Maqedoni, populli shqiptar deri në vitin 2006 ka patur vetëm një institucion kulturor profesional të përgjysmuar. Me ndihmen e PDSH-së, kur erdhi nëqeveri më 2006-tën, brenda 18 muajve u themeluan edhe 4 institucione të reja që vepronin në kuadër të kulturës dhe sot këto institucione mbulohen me minimumin e buxhetit nga Ministria e Kulturës - me 2% të buxhetit. Institucionet e operës dhe baletit, filharmonisë, etj. i takojnë veprimtarisë muzikore që shqiptarët fare nuk i kanë. Këtu bëjnë pjesë edhe Shoqëritë Kulturore Artistike të shqiptarëve, të cilat angazhohen për realizimin e aktiviteteve të ndryshme artistike dhe bëjnë përpjekje për një ekzistim të mundshëm duke kërkuar mënyra të ndryshme të financimit, pasi që Ministria e Kulturës nuk i përmbush kërkesat e tyre të përgjithshme. PDSH-ja në veprimtarinë filmike përfshin veprimtarinë e produksionit të veprave audiovizuale. Në fushën e teatrit dhe filmit artistëve u kufizohet mundësia e veprimit artistik, sepse, producentëve dhe regjisorëve shqiptar të filmi u jepen shuma minimale për realizimin e veprave filmike. PDSH-ja në fushën e galerive të artit përfshin organizimin dhe ekspozimin publik të veprave nga arti figurativ si dhe fotografia artistike, veprave letrare dhe muzikore, etj. Kjo nuk mjafton. Populli ynë ka nevojë për hapjen e galerive të reja në qytete të ndryshme të Republikës së Maqedonisë

PDSH-ja në ekzistimin e qendrave kulturore përfshin inicimin, inspirimin dhe zhvillimin e krijimtarisë kulturoro-artistike të fëmijëve, të të rinjve, por, doemos edhe si qendër për realizimin e të gjitha veprimtarive kulturore.

Në qytetet e Maqedonisë perëndimore ku në numër të madh jetojnë shqiptarët dhe atje mungon ekzistimi dhe funksionimi i institucioneve kulturore shqiptare, të cilët do të kujdesen për zhvillimin dhe rritjen e veprimtarive të ndryshme kulturore. Prandaj, ekzistimi i këtyre qendrave është nevojë e domosdoshme. PDSH-ja në veprimtarinë për mbrojtje dhe shfrytëzim të pasurisë kulturore të tundshme dhe të patundshme përfshin:

1. Muzeume
2. Kinema
3. Veprimtari për mbrojtje të përmendoreve kulturore
4. Veprimtari për mbrojtje të përmendoreve dhe përkujtimeve.

Populli shqiptar fare pak merr pjesë në veprimtaritë kulturore të lartpërmendura. Që të zhvillohet në kontinuitet një kinematografi kombëtare duhet zhvillim i të gjitha komponenteve elementare: prodhimi filmik, distribuimi, prezentimi dhe zhvillimi i veprimtarisë kinematike si dhe zhvillimin e filmit amator. Kinematë që ekzistojnë në të gjitha vendet ku jeton populli shqiptar nuk funksionojnë, prandaj, nevojitet sanimi dhe adaptimi i këtyre objekteve ekzistuese që të mundësohet prezentimi i trashëgimisë filmike. Duhet theksuar nevojën për ekzistimin e përmendoreve kulturore dhe përkujtimeve të kombit shqiptar. Pra, nga e gjithë kjo përfundojmë se për pjesëmarrjen e shqiptarëve në të gjitha veprimtaritë kulturore, Ministria e Kulturës ka financuar diku 2% nga Buxheti i saj. Të gjitha këto fakte flasin për diskriminimin e madh që ekziston si pasojë e politikës së kësaj qeverie, në vecanti në sferën e kulturës.

B. Qëllimet dhe prioritetet e kulturës shqiptare sipas përcaktimit të partisë demokratike shqiptare

1. PDSH-ja vlerëson se krijimi i vlerave kulturore kombëtare ka rëndësi parësore për ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit kombëtar.
2. PDSH-ja vlerëson se kultura është në funksion të zhvillimit të përgjithshëm shoqëror.

3. PDSH-ja përkrah dhe kultivon vlerat tradicionale kulturore kombëtare.
4. PDSH-ja insiston rikonstruktimin e Buxhetit republikan në favor të aktiviteteve programore shqiptare në sferën e kulturës.
5. PDSH-ja insiston për pjesëmarrje proporcionale të mjeteve buxhetore për projekte kulturore me interes kombëtar.
6. PDSH-ja insiston për investime me përkujdesje shtetërore në fushën e krijimtarisë kulturore.
7. PDSH-ja insiston lidhjen dhe anëtarësimin me asociacionet ndërkombëtare, fondet dhe fondacionet e ndryshme.
8. PDSH-ja angazhohet për ngritjen e institucioneve kulturore të financuara nga shteti në vijë të zhvillimit, ruajtjes dhe begatimit të vlerave.
9. PDSH-ja angazhohet për themelimin e institucioneve të pavarura dhe autonome, të financuara nga Buxheti i shtetit, që do të jenë në funksion të zhvillimit të veçorive kulturore kombëtare.
10. PDSH-ja angazhohet për formimin e institucioneve kulturore në nivel lokal.
11. PDSH-ja angazhohet për shpejtimin e proceseve integruese regjionale dhe globale në sferën kulturore, të bazuara në nevoja dhe interesa të përbashkëta objektive.
12. PDSH-ja angazhohet për bashkëpunim dhe komunikim në sferën e kulturës shqiptare me maqedonasit dhe etnitetet tjera të Maqedonisë.
13. PDSH-ja angazhohet për funksionim të papenguar të komunikimit kulturor ndërmjet Maqedonisë, Shqipërisë dhe Kosovës në funksion të zhvillimit harmonik kombëtar.
14. PDSH-ja angazhohet për funksionim të papenguar të komunikimit kulturor në nivel ndërkombëtar.
15. PDSH-ja angazhohet për përkrahje të artistëve të lirë.
16. PDSH-ja angazhohet për krijimin e kriterëve të vlerësimit, për qëllimet dhe përparësitë në politikën kulturore.
17. PDSH-ja insiston për afirmim të pluralizmit kulturor.
18. PDSH-ja angazhohet për mbrojtjen e pasurisë dhe trashëgimisë kulturore dhe prezentimit të tyre.
19. PDSH-ja angazhohet për organizim dhe zhvillim të manifestimeve kulturore si dhe për sigurimin e çmimeve dhe shpërblimeve.

20. PDSH-ja angazhohet për sanimin dhe revitalizimin e objekteve kulturore si dhe përmirësimin e kushteve tekniko – teknologjike.
21. PDSH-ja angazhohet për rindërtimin, restaurimin dhe mbrojtjen e barabartë shtetërore të përmendoreve dhe monumenteve kulturore historike shqiptare (kombëtare dhe fetare), të periudhave të ndryshme, të antikitetit, të mesjetës dhe të Perandorisë Otomane.
22. PDSH-ja kujdeset për interesin individual të kulturës, për interesin lokal dhe atë kombëtar.
23. PDSH-ja angazhohet për afirmimin dhe përkrahjen e autorit si subjekt themelor të kulturës.
24. PDSH-ja angazhohet për krijimin e strukturës kadrovike, përkrahjen e artistëve të rinj dhe për afirmimin e veprës së tyre.
25. PDSH-ja angazhohet për bursa dhe benificione të tjera për nxënësit dhe studentët në sferën e kulturës.
26. PDSH-ja angazhohet për kushte të zhvillimit të marrëdhënieve tregtare dhe menaxhmentit në kulturë.
27. PDSH-ja angazhohet për nevojat, kushtet dhe investimet hulumtuese të vlerave kulturore.
28. PDSH-ja angazhohet për shfrytëzimin e teknologjive elektronike për produksion dhe për prezentim të mundësive dhe arritjeve të kulturës shqiptare.
29. PDSH-ja angazhohet për marketing intensiv dhe kontinual të kulturës nëpër medime.

C. Programi kombëtar për kulturë sipas përcaktimit tëpdsh-së

Gjatë katër viteve të ardhshme koalicionimi në Qeveri, Partia Demokratike Shqiptare parasheh që ta intensifikojë institucionalizimin e jetës kulturore të shqiptarëve të Maqedonisë. Programi partiak, i cili mbështetet në platformën kombëtare të PDSH-së, parasheh që gjatë katër viteve të ardhshme të sendërtohen një sërë iniciativash si në rrafshin kulturor ashtu edhe në investimet kapitale, siç janë:

1. Përgatitja e resurseve të reja për menaxhim profesional me politikat kulturore si dhe me institucionet dhe asociacionet kulturore shqiptare në vend.
2. Investim në krijimin e resurseve deficitare, si në sferën e arkeologjisë, restaurimit dhe arkivimit të artefakteve zhvillimn e koreografisë, baletit, muzikën klasike, në sferën produksionit te filmit.
3. Fillimisht themelimi i një operës kamertale në Tetovë.
4. Formimi i një festivali të muzikës kamertale në Shkup.
5. Krijimi i kushteve për themelimin e orkestrës adekuate, që do të jetë në funksion të operës dhe trupës fillestare që do të ngritet në balet.
6. Themelimi i ansambllit kombëtar të këngëve dhe valleve
7. Themelimi i trupës teatrale shqiptare në kuadër të teatrit të Kumanovës
8. Ngritja e godinës së Art Qendrës për artet pamore në Gostivar.
9. Ngritja e drejtorisë së Ditëve të kulturës shqiptare.
10. Themelimi i Teatrit të Strugës,
11. Zhvillimi i festivaleve nderkombetare: të këngëve dhe valleve, Festivali i e filmit të shkurtër ndërkombëtar, java e filmave të shteteve të ndryshme, java e jazz-it dhe etno jazz-it mbarëkombëtar, do të jenë disa nga aktivitetet kulturore, të cilat do të mëtojnë zhvillimin e një turizmi kulturor si dhe të promovimit të Strugës në një qendër jo vetëm turistike, por edhe kulturore ndërkombëtare.
12. Ndërtimi i një fshati turistik kulturor në malësinë e Tetovës, i cili do të gjallëronte ekskluzivisht përmes kultivimit të zejeve tradicionale, që nga veglat për punë deri te veglat muzikore, nga veshja kombëtare e deri në përgatitjen e pajës, pse jo edhe në përgatitjen e ushqimit nga kuzhina kombëtare.
13. Krijimi dhe promovimi i viseve, fshatrave e lokaliteteve të ndryshme filmike, me qëllim të joshjes së producentëve dhe regjisorëve të ndryshëm për xhirime filmike nëpër vendbanime shqiptare.
14. Themelimi i Forumit të shkrimtarëve shqiptarë të Maqedonisë.
15. Themelimi i Forumit të përkthyesëve shqiptarë.

Miratimi i ligjit që do të avanconte gjuhën shqipe si dhe do të sanksiononte të gjitha mediat dhe botimet që nuk do të zbatonin rregullat e Drejtshkrimin të Gjuhës Shqipe.

1. Adaptimi i disa objekteve nëpër vendbanime shqiptare për koloni të arteve pamore.
2. Ngritja e Bibliotekës në Tetovë.
3. Ngritja e sallës koncertale për aktivitete muzikoro-skenike.
4. Ngritja e godinës së Teatrit të Tetovës.
5. Ngritja e qendrave kulturore nëpër komunat e administruara nga shqiptarët.
6. Investime në meremetim të shtëpive dhe të qendrave kulturore të menaxhuara nga shqiptarët, adaptim të sallave të këtyre qendrave për aktivitete teatrale e filmike, pajisja e tyre me projektorë adapt për shfaqjen e filmave.

Përmes zhvillimit të këtyre politikave kulturore, pa dyshim Partia Demokratike Shqiptare do të ndikonte ndjeshëm jo vetëm në avancimin e jetës kulturore, por edhe në përplotësimin dhe institucionalizimin e jetës kulturore shqiptare në Maqedoni. Me këtë program kulturor shqiptarët e vendit jo që do të zhvillonin një jetë më të bujshme kulturore, por, së shpejti do të jenë në gjendje të prodhojnë vlera të larta të pranueshme për gara kulturore kombëtare e ndërkombëtare.

SHËNDETËSIA

A. Mbrojtja shendetësore të drejte dhe efikase

Në mungesë të shëndetësisë cilësore dekadën e fundit si pasoje e diskriminimeve në të gjitha fushat nga ana e qeverisë, PDSH-ja konsideron se është imperativ i kohës të bëhen reforma në fushën e shëndetësisë me qëllim që të përmirësohet mbrojtja shendetësore e shqiptareve.

Në krijimin e politikës shendetësore, PDSH-ja angazhohet për ndërtimin e një sistemi më të avancuar të mbrojtjes shendetësore me karakter social dhe të bazuar në ngritjen e cilësive të institucioneve shendetësore.

PDSH-ja punon në përmirësimin e sistemit të mbrojtjes shendetësore që do t'i kënaqë nevojat e të gjithë qytetarëve, duke e bërë atë më cilësor, më transparent dhe më efikas.

Programi shendetësor i PDSH-së do të ndjekë këto synime strategjike:

1. Reformimin e tërësishëm të sistemit aktual shendetësor
2. Decentralizimin e sistemit shendetësor
3. Përmirësimin e jetës së qytetarëve në lidhje me shëndetin
4. Zvogëlimin e dallimeve në kujdesin shendetësor etj.

B. Çfarë e karakterizon sistemin aktual të shëndetësisë

Sistemi shendetësor aktual i Maqedonisë është sistem ende i pa reformuar në kuadër të kërkesave të Unionit Evropian që njëkohësisht karakterizohet me një shërbim jo kualitativ për qytetarët, me një financim jo adekuat dhe jo-proporcional, një sistem që është i politizuar dhe i centralizuar tej mase. Ky sistem de-motivon punonjësit sepse ka procedura strikte, planifikim të tipizuar për të gjithë nivelet dhe paga jo të barabarta dhe tepër të ulta. Gjithashtu shërbimet shendetësore janë të një niveli të ulët, gjë për të cilën duhet ndjekur dhe planifikuar një politikë shendetësore që do t'i përmbushë kërkesat e qytetarëve.

C. Veprimtaria shendetësore

Modernizim dhe menaxhim më i mirë i sistemit të mbrojtjes shendetësore

PDSH-ja në mënyrë permanente do të angazhohet për modernizimin e sistemit të mbrojtjes shëndetësore në përputhje me standardet e EU-së. Theks i veçantë do t'i kushtohet financimit në sistemin e mbrojtjes shëndetësore, nxitjes së konkurrencës si mjet për realizimin e reformave në shëndetësi.

PDSH-ja do të miratojë akte ligjore për sigurimin e privatësisë, besueshmërisë, si dhe sigurisë së informacionit dhe detyrimet e pjesëmarrësve në krijimin, shpërndarjen dhe shfrytëzimin e informacioneve me qëllim të mbrojtjes së të drejtave themelore të qytetarëve.

PDSH me politikën e saj shëndetësore do të sigurojë mjete financiare dhe materiale për meremetimin e spitaleve dhe pajisjen e tyre me aparaturë moderne. Në këtë projekt janë të përfshirë 8 klinika spitalore, 5 spitale dhe dy shtëpi të shëndetit.

PDSH-ja do të angazhohet në ruajtjen dhe përmirësimin e gjendjes shëndetësore të të gjithë qytetarëve si: fëmijët, pleqtë, shtatzënat, personat me nevoja të posaçme, si dhe të sëmurët kronikë. Andaj PDSH-ja dhe më tutje do të zbatojë programe preventive, si ato të detektimit të hershëm të sëmundjeve malinje të gratë, këshilla për shëndet më të mirë për çka edhe do të ndahen mjete për kontrollime mjekësore falas për të gjithë qytetarët, si dhe programe për imunizim dhe kontroll të sëmundjeve ngjitëse.

PDSH-ja nuk do të lë anash edhe bashkëpunimin e ngushtë me shtetet fqinje, si Shqipërinë dhe Kosovën, për të shfrytëzuar kapacitetet mjekësore dhe për të realizuar programe zhvillimore për shërbime të ndërsjella mjekësore dhe edukativo-shkencore. Bashkëpunimin do ta shtrijë edhe me ekspertë nga qendra mjekësore me renome ndërkombëtare me qëllim të shkëmbimit të përvojave pozitive me shtetet e zhvilluara.

D. Mbrojtjashëndetësorembrojtja shëndetësore primare

Veprimtaria shëndetësore do të jetë e përqendruar në transformimin e mëturjtshëm të mbrojtjes shëndetësore primare duke i siguruar asaj vendin kryesor në sistemin e mbrojtjes shëndetësore dhe duke e orientuar atë kah bashkësia.

PDSH-ja në shëndetësinë primare do të ngrëjë nivelin e shërbimeve të ofruara nga programet aktuale që kanë të bëjnë me programin për mbrojtjen aktive shëndetësore-nënë dhe fëmijë, kontrolleve sistematike të nxënësve dhe studentëve, shëndet për të gjithë dhe programi i patronazhës.

PDSH-ja do të angazhohet në krijimin e modeleve të reja të shërbimeve shëndetësore me aplikim të modelit të kapitacionit ku në qendër të vëmendjes do të jetë pacienti dhe shërbimi cilësorë shëndetësor.

PDSH me programin e saj do të vazhdojë të sigurojë furnizimin e njëtrajtshëm me aparaturë të nevojshme të të gjitha institucioneve të mbrojtjes shëndetësore primare.

E. Mbrojtja shëndetësore sekondare dhe terciare

PDSH-ja do të investojë me miliona euro në ri-konstruimin e objekteve shëndetësore dhe spitaleve në Republikën e Maqedonisë Veriperëndimore duke filluar nga Kumanova, Shkupi, Tetova, Gostivari, Struga, Dibra, etj.

Spitali klinik i Tetovës, projekt ky i realizuar nga ana e PDSH-se në mandatin 2006-2008, do të transformohet në Klinike Universitare. Me këtë transformim Klinika Universitare do të jetë bazë edukativo-arsimore dhe shëndetësore cilësore për të gjithë studentet e Fakultetit të Mjekësisë dhe të Stomatologjisë në Universitetin s Tetovës, por edhe klinikë me cilësi shumë më të lartë të shërbimeve shëndetësore për pacientët e Maqedonisë perëndimore. Ky investim nuk është i rëndësishëm vetëm për faktin që qytetarëve do t'udo të ofrojë ndihmën e duhur, por aty ata do të mund të marrin shërbime të një niveli më të lartë. Një kapacitet i tillë siguron edhe hapjen e vendeve të reja të punës. Ky investim paraqet vendosje të një themeli të shëndoshë të Fakultetit të Mjekësisë dhe të Stomatologjisë. Në

kuadër të këtij angazhimi PDSH do të mundësojë formimin e Klinikës Stomatologjike në Tetovë.

PDSH do të angazhohet që në kuadër të Klinikës Universitare të formohen institute si ai i anatomisë, i patologjisë, i fiziologjisë, i patofiziologjisë, i mikrobiologjisë, i farmakologjisë si dhe institute të tjera të nevojshme për funksionimin e mirëfilltë të Klinikës Universitare.

Në kuadër të kësaj PDSH-ja do të angazhohet që në mënyrë permanente të riedukojë specialistët në lëmi të ndryshme jashtë vendit, nëpër qendra mjekësore me renome botërore.